



# D R I T A

“Drita lufton kundër errësirës kur ndriçon.”

KEPPLER

E PËRMUAJSHME FETARE - KULTURORE E KISHËS KATOLIKE

Prizren • Nëntor 2008 • Viti XXV • Nr. 11 (169) • Çmimi: Kosovë 1€, Europë 2€, Zvicër 3SFR, SHBA \$2.50



**BIBLA FJALA E ZOTIT E CILA DUHET JETUAR**

FAQE 6-7

Shkruan:  
DON JETON THAQI



**“ZOTI ËSHTË AQ I MADH, SA QË IA VLEN T’IA DHUROSH TËRË JETËN”**

FAQE 10-11

Shkruan:  
VIOLETA MARASHI

**PRESIDENTI WILSON DHE ÇËSHTJA SHQIPTARE 1919-1920**

FAQE 11-12

Shkruan:  
PROF. DR. LUSH CULAJ



## Koha e Ardhjes – kohë shprese

■ SHKRUAN:  
Fra Lovro Gavran, O.F.M.

Njeriu është qenie shprese. Pa shpresë ai nuk do të mund të jetonte. Shpresa i jep fuqi për t’i përballuar krizat e ndryshme gjatë jetës dhe për të ecur drejt një jete më të mirë, e cila momentalisht nuk ekziston, as nuk ka ekzistuar kurrë – por mendja jonë na thotë se është e mundshme. Kush nuk beson se ajo është e mundshme, dhe kush nuk shpreson se ajo herë do-kurdo, mund dhe duhet të realizohet, megjithëse momentalisht nuk ekziston, ai kurrë nuk do të përpigjet rreth realizimit të një jete të tillë dhe kurrë nuk do të ndryshojë gjendjen e vet të njerë, e cila momentalisht e mundon.

Të gjithë shkencëtarët, zbuluesit, shpikësit, mjekët, mësuesit, çdo lloj intelektual, besimtarët, punëtorët, bujqit – të gjithë pa dallim, janë njerëz të shpresës. Mos të kishin shpresën e suksesit, as nuk do të punonin dhe as nuk do të lodheshin rreth ndonjë ndryshimi në jetën e vet. Pa këtë shpresë nxënësi nuk do të mësonte gjë, mësuesi nuk do të jepte mësim, mjeku nuk do të shëronte, prindi nuk do të kujdesej për fëmijë, bujku nuk do ta punonte tokën... Por të gjitha këto ne i bëjmë, sepse kemi shpresë se nuk lodhemi kot. Pra, jemi njerëz të shpresës.

Shpresa është dhuratë e Zotit. Hyji Krijues e ka krijuar njeriun me një “dije të pamësuar” – me një shpresë që i tejkalon horizontet e të dukshmes, që kërkon të padukshmen, madje edhe të përcaktuar, me një bindje se ajo mund të arrihet dhe të realizohet. Kështu shpresojmë se kjo botë me angazhimin tonë mund të bëhet më e mirë, më paqedashëse, më e njerëzishme, më e drejtë, më bujare, më fisnike, më e kulturuar, më e bukur, më e pëlqyeshme, më e këndshme për jetë, më miqësore, më e dashur...

Krijuesi ia ka mbjellë njeriut në zemër edhe një shpresë tjetër, më të lartë, mbinatyrore – shpresën që e tejkalon këtë jetë dhe e kapërcen vdekjen dhe varrin. Kjo është shpresa e jetës së amshuar, shpresë e lumturisë së përhershme në Mbretërinë e Zotit, të cilën në një anë e bren, e në anën tjetër e afirmon edhe frika e natyrshme nga shkatërrimi dhe disata e përhershme në mundimet e ferrit. Këtë shpresë njeriu e ka që prej momentit kur u bë njeri. Ajo dikur është më e errët, e dikur pak më e kthjellët, por ekziston gjithmonë.

Këtë shpresë mbinatyrore posaçërisht e ka kultivuar me shekuj populli izraelit, duke u mbështetur në zbulimin e Zotit dhe në premtimet e tij – sidomos prej Abrahamit e këndej. Objekti kryesor i shpresës së tyre ishte pritja e Mesisë, e Shëlbuesit të premtuar, i cili më në fund edhe erdhi në personin e Jezu Krishtit, i cili na e zbuloi fytyrën e vërtetë të Zotit tonë, i cili për ne, fëmijët e vet, është Atë i dashur qiellor, e jo njëfarë fuqie indiferente mbinatyrore, e cila nuk do të ishte e interesuar për fatin e njeriut dhe për problemet e tij.

Jezusi na e zbuloi edhe të ardhmen tonë dhe të mbarë botës: bota ka fillimin dhe mbarimin e vet. Ajo shkon drejt përfundimit. Në mbarimin e botës Jezusi do të vijë prapë. Do të vijë në lavdinë e vet hyjnore, si gjykatës i mbarë njerëzimit – për ta shpërblyer të mirën dhe për ta ndëshkuar të keqen, për t’ua dhënë lumturinë e amshuar të mirëve, besnikëve, të vuajturve, të shkelurve, të munduarve, të përndjekurve – dhe për t’ua dhënë ndëshkimin e merituar të padrejtëve, mendjemdhënjeve, tiranëve, terroristëve, agresorëve, dhunuesve dhe mëkatarëve të papenduar të çfarëdo lloji.

Çdo vit katër javë para Krishtlindjes Kisha Katolike e kremton kohën e shenjtë të Ardhjes, e cila është kohë shprese dhe kohë pritjeje. Në këtë kohë e përkujtojmë kohën e pritjes së Shëlbuesit nga ana e popullit izraelit dhe nga krejt bota, por njëkohësisht presim edhe ardhjen e dytë të Shëlbuesit tonë në mbarimin e kohërave. Me pritje të tillë më së miri përgatitemi edhe për kremtimin e Krishtlindjes, e cila është festa më e gëzueshme e krishterimit – sepse është festë e plotësimi të premtimeve të Zotit dhe festë e realizimit të shpresave të njeriut.



## Arbërit ndërmjet Lindjes dhe Perëndimit

FAQE 14-15

Shkruan:  
Prof. dr. Jahja DRANÇOLLI

**Intervista me myfti Rexhep Bojën Kisha Katolike dhe Bashkësia Islame e Kosovës - të bashkuara në gëzimet dhe hidhërimet e fatit të popullit tonë**

FAQE 12



Tribuna shkencore "Mitrovica me rrethinë nëpër shekuj"

## E kaluara e Mitrovicës përmes ndriçimit të së sotmes

*Nga ajo që u tha në këtë tribunë, përmes referimit të kumtesave, mund të dëshmohet, se ndriçimi i të kaluarës duhet të na shërbejë për ndërtimin e të tashmes dhe të ardhmes*

19 tetor 2008.

Në Mitrovicë, në Shtëpinë e Kulturës "Rexhep Mitrovica" u mbajt tribuna shkencore "Mitrovica me rrethinë nëpër shekuj". Kjo ishte tribuna e dytë me radhë pas asaj që u mbajt në muajin qershor të këtij viti. Në këtë tribunë shkencore, të

me kumtesat e tyre, pasqyruan të kaluarën historike të qytetit të Mitrovicës me rrethinë. Në tubim ishin të pranishëm përfaqësuesi i Ipeshkvisë së Kosovës dr. don Lush Gjergji, kryetari i Komunës së Mitrovicës Bajram Rexhepi, përfaqësues të KFOR-it dhe të organizatave tjera

Sesionin e hapi famullitari i kishës së Mitrovicës don Pashk Dani, i cili i përshëndeti pjesëmarrësit dhe falënderoi studiuesit për kumtesat e tyre, të cilat do të pasqyrojnë të kaluarën e një treve të rëndësishme të Kosovës, siç është Mitrovica me rrethinë. Duke folur për qëllimin e këtij sesi

për të kaluarën dhe të sotmen e saj. Në emër të Ipeshkvisë së Kosovës të pranishmit i përshëndeti dr. don Lush Gjergji i cili vlerësoi kontributin e shkencës në të mirë të ndriçimit të së kaluarës.

Studiuesit e fushave të ndryshme që morën pjesë në këtë tribunë lexuan kumtesat e tyre, ku trajtuan aspekte të rëndësishme që kanë të bëjnë me të kaluarën e Mitrovicës dhe të rrethinës së saj. Studiuesi Rexhep Doçi u paraqit me kumtesën "Rreth prejardhjes së Ojkonomit Mitrovicë". Përmes kësaj kumtese, Doçi theksoi se ojkonomi Mitrovicë përmendet që nga viti 1318 në Kristobulën e Bajnskes së Zveçanit, ku kisha e këtij lokaliteti njihet si kisha e Dhimrit. Ai tha se ky ojkonom përmendet në forma të ndryshme nga shqiptarët, në pjesë të ndryshme të Kosovës. Egilale Dobruna lexoi kumtesën "Monumente të gurit në trevën e Mitrovicës gjatë kohës romake". Dr. Shpëtim Bulliqi dhe Dr. Florim Isufi u prezantuan me temën "Energjia e relievit në pjesën VL të Kosovës". Prof dr. Naser Ferri u paraqit me kumtesën "Gërshtimi i qytetërimeve në rajonin e Mitrovicës gjatë antikës". Mr. Kujtime Boshtrakaj-Camaj prezantoi kumtesën "Gjurmimet

e krishterimit të hershëm në regjionin e Mitrovicës me rrethinë". Kumtesa e Dr. Mehmet Halimit ishte "Toponimet kompozitor në trevën e Mitrovicës me rrethinë". Dr Adem Zejnullahu lexoi kumtesën "Figurat e shquara shqiptare në këngët popullore". Kumtesa "Banesa qytetare të Mitrovicës" u paraqit nga autorja Mr. Rrezarta Logja. Mr Bektesh Vidishiqi ligjëroi kumtesën "Mitrovica, karakteristikat dhe zhvillimi urban", Daut Bislimi prezantoi punimin e tij "Onomastika e Mitrovicës me rrethinë në Mesjetë". Fazli Hajrizi lexoi kumtesën "Figura e Isa Boletinit në këngë popullore, historike në Shalë të Bajgorës".

Nga ajo që tha në këtë tribunë, përmes referimit të kumtesave, mund të dëshmohet se ndriçimi i të kaluarës duhet të na shërbejë për ndërtimin e të tashmes dhe të ardhmes.

Në pjesën e dytë të këtij tubimi u shfaq një program muzikor, ku rapsohet Lekë Duhani e Gjokë Duhani kënduan këngë folklorike për figurat e ndritura kombëtare. Në fjalën e tij përmbilëse, don Pashk Dani i falënderoi të gjithë të pranishmit për pjesëmarrje dhe u premtoi referuesve se kumtesat e prezantuara në këtë tribunë do t'i u ofrohen edhe lexuesve tjerë përmes një botimi të veçantë. (Prof. Pal Canaj)



Gjatë tribunës shkencore në Mitrovicë

organizuar nga Kisha Katolike e Mitrovicës dhe nga Kuvendi Komunal, merrnin pjesë studiues nga lëmi të ndryshme, të cilët,

ndërkombëtare, si dhe pjesëmarrës tjerë nga qyteti i Mitrovicës dhe vendeve të ndryshme të Kosovës.

qytetaret e Mitrovicës. Sipas Rexhepit zëri i shkencëtarëve dhe historianëve është shumë i rëndësishëm për Mitrovicën,

## Ipeshkvi ndihmës i Pragës Vaclav Maly vizitoi Kosovën

Nga data 9-11 nëntor 2008, në organizim të Ambasadës Çeke, Kosovën e vizitoi Ipeshkvi ndihmës i Pragës, Mons. Vaclav Maly. Ndër takimet e tij të veçuara ishin; takimet me përfaqësuesit e Bashkësisë Islame, asaj Katolike, Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut etj.

Në Prishtinë, me 10 nëntor, pas takimit me Myftiun e Kosovës Naim Tërnavë në Bashkësinë Islame pasoi vizita Medresesë. Para nxënësve, ipeshkvi i Nderuar Maly, ndër tjera foli mbi rëndësinë e kultivimit të dialogut ndërfetar. Në këtë vizitë, mori pjesë edhe ipeshkvi i Kosovës Mons. Dodë Gjergji. Më pas, ipeshkvi Maly, u njoh-

tua me disa projekte të përbashkëta të Bashkësisë Islame dhe Kishës Katolike, siç është ai lidhur me luftën kundër trafikimit me genie njerëzore.

Ipeshkvi Maly, i shoqëruar nga ipeshkvi i Kosovës Mons. Dodë Gjergji, vizitoi edhe vendin ku po ndërtohet Katedralja dhe u njohua me projektin në fjalë. Pas drekës të shtruar nga Ambasadorja e Çekisë, Znj. Janina Hrebickova, së bashku vizituan qytetin e Mitrovicës. Me këtë rast, liderët fetarë, Katolik e Mysliman, bashkë me mysafirin e tyre, vizituan selinë e Caritasit të Kosovës, në të cilin bashkëpunojnë njerëz të etnive e feve të ndryshme, dhe më pas, kaluan këmbë mbi urën e cila ndan këtë qytet. Ata uruan

që në të ardhmen kjo urë të jetë simbol i paqes dhe bashkimit.

Vizita e ipeshkvit Maly, vazhdoi në Prizren në Selinë Ipeshkvore.

Ndërsa, më 11 nëntor, ipeshkvi Maly vizitoi manastirin e Deçanit, kishën katolike dhe xhaminë e vjetër në Gjakovë. Pas drekës së përbashkët shtruar nga Bashkësia Islame e Kosovës, ipeshkvi Maly vizitën e vazhdoi në Viti, Binçë dhe Letnicë.

Gjatë gjithë kësaj vizite, ipeshkvi Maly u impresionua nga marrëdhëniet e mira në mes Bashkësisë Islame dhe Kishës Katolike, me dëshirën që kjo frymë tolerance dhe bashkëpunimi mes tyre të rezultojë në mirëqenien e të gjithëve në Kosovë.



Mons. Dodë Gjergji, Naim Tërnavë, Vaclav Maly, Janina Hrebickova dhe don Viktor Sopi



# Vizita studimore e karvanit të paqes

Duke marrë në konsideratë rëndësinë e veçantë të bashkësive të ndryshme fetare që jetojnë në rajonin e Ballkanit, Caritasi i Kosovës organizoi një vizitë studimore – konferencë katër ditore, të quajtur "Karvani i Paqes," e cila u mbajt prej 27. 10. 2008 deri më 30.10. 2008 në Prishtinë.

Në fakt, kjo vizitë studimore është iniciuar në Jerusalemin në vitin 2005 nga Caritasi francez – Secours Catholique, duke i bashkuar përfaqësues të lartë të organizatave dhe të bashkësive të ndryshme fetare nga Kosova, Shqipëria, Maqedonia, Serbia, Kroacia dhe Bosnja e Hercegovina. Më pas, në vitin 2006 u organizua në Beograd dhe në vitin 2007 në Sarajevë.

Objektivat kryesore të këtij projekti janë përforcimi i marrëdhënieve ndërfetare dhe ndërtimit në rajon dhe më gjerë, duke promovuar paqen, solidaritetin dhe dialogun, si dhe ndërveprimet në mes institucioneve të ndryshme.

Në Kosovë ishte takimi i katërt multi-religjioz, pas takimeve me radhë të përmendur më lart, ku morën pjesë don Viktor Sopi, drejtor i përgjithshëm i Caritas të Kosovës, Mons. Bosilko Rajić, drejtor i Caritasit të Bosnjës dhe Hercegovinës, Z. Qemajl Morina, përfaqësues i Bashkësisë Islame të Kosovës, Don Vladislav Varga, drejtor i Caritasit të Serbisë dhe Malit të Zi, Prof. Dr. Ratimir Groždanoski, përfaqësues i kishës ortodokse të Maqedonisë, Z. Vlash Plepi, përfaqësues i kishës ortodokse shqiptare, Znj. Ana Stakaj, përfaqësues e Caritasit Shqiptar, Z. Mark Boga, Caritasi Shqiptar, Znj. Geneviève Colas dhe Aurore Arnould, përfaqësues të Caritasit francez (Secours Catholique), Z. Hajrudin Šahić, përfaqësues i bashkësisë islame të BiH dhe organizatës Merhamet, Z. Azim Durnić, përfaqësues i bashkësisë islame të

Kroacisë, Z. Fitim Flugaj, drejtor i organizatës Bereqeti të bashkësisë islame të Kosovës, Z. Kristijan Hrgić, Caritas BiH, Znj. Lenka Groždanoski, kisha ortodokse e Maqedonisë, Z. Jakup Sabedini, Z. Pal Baftiaj, Z. Boban Mirković, Bujar Sahatçiu, Znj. Violeta Ferati, Z. Zef Përgjoka dhe Znj. Dhurata Prokshi, përfaqësues të Caritas Kosova, Znj. Diana Blakaj – Demaj, CRS, Znj. Vlora Durmoshi, CRS, Z. Antonio Fantasia, Caritas Italiana, Znj. Veronika Amort, Caritas Italiana, Znj. Barbara Menssner, Caritas Italiana.

Takimi i Karvanit të Paqes, u hap nga drejtori i Caritasit të Kosovës Don Viktor Sopi, i cili duke i përshëndetur të pranishmit vuri theksin në projektin

me organizatën Bereqeti, duke e veçuar si një mjet i aktivitetit të përbashkët. Po ashtu, ky projekt është zhvilluar edhe në bashkëpunim me partnerët të tjerë si CRS, PVPT, KOPF, me Qeverinë e Kosovës dhe me SHPK, tha në fund don Viktor Sopi.

Pas prezantimit të mysafirëve, Karvani i Paqes vizitoi Bashkësinë Islame të Kosovës, ku u prit nga Kryeimami Sabri Bajgora, i cili e përgëzoi Karvanin e Paqes për misionin e tyre. Ai tha se me bashkëpunim duhet të ndërtojmë ardhmërinë në paqe.

Më pas, Karvani i Paqes vazhdoi rrugën drejt Medresesë ku ishte e ofruar dreka e përbashkët dhe një bashkëbisedim me drejtorin e medresesë z. Bahri Simnica, duke i njoftuar pjesëmarrë-

sion fisnik, duke shprehur keqardhjen e tij për mospjesëmarrjen e kishës ortodokse serbe në këtë Karvan të Paqes dhe ai uroi që kjo Kishë të gjejë veten dhe të jetë participuese në Kosovë.

Programi i ditës së parë të Karvanit të Paqes vijoi me takimin me kryetarin e Kuvendit Komunal të Ferizajt Bajrush Xhemajli.

Karvani i Paqes vazhdoi vizitën përreth Kishës ortodokse dhe Këshillin e bashkësisë islame në Ferizaj, të cilat janë të ndërtuara në të njëjtin oborr, një ndër rastet e rralla në Kosovë e më gjerë. Më pas vizitat vazhduan në Kishën katolike në Ferizaj dhe Caritasin e Kosovës.

Pas analizës dhe refleksioneve të të gjithë pjesëmarrësve, Karvani i Paqes u nis për Priz-

butin për bashkëjetesë: "Kisha nuk mund të bëjë gjë tjetër përveç promovimit të paqes. Shpresoj që kjo filozofi është në zemrat e të gjithëve dhe kjo të transmetohet kudo. E rëndësishme është që ne të gjejmë forcat për të demonstruar vlerën e paqes, atë vlerë që ne e bartin". Më pas, në Katedralen në Prizren, u mbajt një lutje e përbashkët në mbështetje të nismës së Karvanit të Paqes, të cilën e udhëhoqën Imzot Dodë Gjergji, por lutja u tha edhe nga përfaqësuesi i Bashkësisë Islame të Kosovës (Shoqata Bereqeti), pastaj nga përfaqësuesi i kishës ortodokse të Maqedonisë, Prof. Dr. Ratimir Groždanoski.

Në fund, drejtori i Caritas-it të Kosovës Don Viktor Sopi, për sa i përket mungesës së kishës ortodokse serbe në Karvanin e Paqes, tha se kjo është një përpjekje e shkurtër pas pavarësisë së Kosovës, por nuk do të thotë se nuk ka dialog në Kosovë dhe nuk do të ketë në të ardhmen: "Shpresoj që Caritas-i i Kosovës, do të jetësojë memorandumin e bashkëpunimit me Bashkësinë Islame që në të ardhmen të këmijë dhe Kishën Ortodokse serbe. Arqipeshkvi i Beogradit është model se si duhet të gjenden mënyrat për krijimin e urave të komunikimit, por pengon elementin politik serb, -theksoi Don Viktor Sopi.

Sipas tij, Karvani i Paqes ka arritur shumë, pasi ky lajm është dhënë në mediet tona në lajmet qendrore, ndërsa e kanë kuptuar të gjithë njerëzit që në këtë Karvan janë kyçur të gjitha religjionet. Ai në fund falënderoi të gjithë pjesëmarrësit për kontributin e tyre në Karvanin e Paqes, në veçanti mbështetësit kryesor Caritas-in francez dhe bashkëkontribuesin tjetër, Caritasin Zviceran.

Krejt në fund të këtij programi u lexua deklarata e mesazhit për paqe. (Jakup Sebadini)



Mons. Dodë Gjergji në mesin e përfaqësuesve të karvanit të paqes

PATH – Partneriteti i luftës kundër trafikimit të genit njerëzor – për të mbrojtur dinjitetin e personit njerëzor, me anë të cilit Caritasi i kishës katolike të Kosovës, nëpërmjet të një Memorandumi të Mirëkuptimit, e implementoi me Bashkësinë islame të Kosovës, respektivisht

si të aktivitetet dhe zhvillimet në këtë shkollë.

Karvani i Paqes u prit edhe nga Presidenti i Kosovës Fatmir Sejdiu. Presidenti Sejdiu falënderoi dhe përgëzoi pjesëmarrësit e takimit. Ai vlerësoi misionin e Karvanit të Paqes dhe porositi të vazhdohej kjo rrugë dhe mi-

ren, ku sipas planprogramit do t'i bëhej një vizitë Ipeshkvit të Kosovës, Imzot Dodë Gjergji dhe Katedrales. Imzot Dodë Gjergji, falënderoi për kontributin që po e jep për Paqe Karvani i Paqes. Ai theksoi që edhe në të ardhmen të gjitha religjionet do të japin kontri-

Grupi "Feja dhe Drita" zhvilloi aktivitetin e tyre në Velezhë

## "Kur e duam dhe e shërbejmë skamnorin, e duam dhe e shërbejmë Krishtin"

Të dielën më 9. 11. 2008 në oborrin e kishës së Shën Nikollës në Velezhë, rinia jonë mirëpriti bashkësinë e Gjakovës, grupin "Feja dhe Drita". Ky takim filloi rreth orës 10:00 dhe menjëherë, që në bisedat e para, ata paraqitën me pak fjalë formimin e grupit të tyre "Feja dhe Drita". Dhe ndër të tjerë mësuan që bashkësia "Feja dhe Drita" u themelua në Lurdë të Francës, në shenjtëroren e Zojës së Bekuar në vitin 1971, nga Jean Vanier. Që nga ajo ditë e gjer më sot, kjo bashkësi zhvillon aktivitetet e saj në mbarë botën dhe fatmirësisht

ky aktivitet ka arritur dhe po funksionon edhe në Gjakovë, gjithmonë duke iu falënderuar angazhimit të madh të fretërvë dhe motrave të Shën Kryqit, e sidomos m. Ratislava Ralbovsky, e cila kishte filluar e para këtë aktivitet në Gjakovë. Grupi "Feja dhe Drita" përfshin nën kujdesin e vet më se 50 persona me aftësi të kufizuara, të cilët me shumë kënaqësi marrin pjesë në takimet e tyre. Shkaku i themelimit të kësaj bashkësie, ishte fakti se numri me aftësi të kufizuara në botë është shumë i madh dhe gjithnjë po rritet dukshëm. Prandaj

edhe po ndihet nevoja për afrimin e tyre si pjesë e shoqërisë njerëzore. Mbas bisedës me të rinjtë, u afua ora 11:00 ku patëm meshën shenjte të udhëhequr nga fra Lovro Gavran dhe Don Jeton Thaqi. Mbas përfundimit të meshës ishte përgatitur edhe një koktej e ku patëm rastin të njihemi më për së afërmi dhe të komunikimim më shumë rreth grupit "Feja dhe Drita" dhe për të gjitha aktivitetet e bujshme të tyre. Ata edhe na argëtuam dhe shfaqën disa nga aktivitetet e tyre mjaft interesante, si me lojëra të ndryshme, vallëzime,

poezi dhe këngë. Mjaft i rëndësishëm ishte edhe komunikimi me të hendikepuarit (personat me nevojë të veçanta), sepse edhe ata janë pjesë e shoqërisë sonë dhe janë personal me të gjitha të drejtat e njeriut. Gjatë momentit të komunikimit me ta, gëzimi i tyre kishte arritur kulmin, sepse sytë e tyre tregonin gjithë harenë dhe lumturinë që ata e përjetonin; edhe ata e ndjenin veten të nderuar dhe të respektuar. Çdo person ka të drejtë të jetojë i lirë dhe ka të drejtë, pa dallim, mbi bazë të nevojave të veçanta mendore, fizike, problemeve të shëndetit

apo aftësive tjera të kufizuara. Ne si famulli, grupi "Feja dhe Drita" u dëshirojmë që t'u realizohen dëshirat e tyre të pashtershme dhe besimin e tyre të vazhdueshëm tek një e ardhme më e mirë për personat me nevojë të veçanta në këtë rajon dhe gjithashtu vullnet dhe çdo të mirë u urojmë edhe motrave të nderit si dhe fra Lovro-s si asistent shpirtëror i grupit, sepse pa vizionin, forcën dhe shembullin e tyre frymëzues në jetën e përditshme, puna dhe suksesi i arritur nuk do ishin realizuar kurrë. (Bergita Oroshi)

Mesha e parë e Don Ambroz Demaj

## Jetoj, por jo më unë, brenda meje jeton Krishti!

Në vitin jubilar të shën Palit, të 160-vjetorit të kthimit të Martirëve të Karadakut në vendlindje (1848 – 2008), në Stubllën, legjendare, që dikush me të drejtë e pati quajtur *miniera e thirrjeve të shenjtë*, ishte mesha e parë e don Ambroz Demaj.

Don Ambrozi, siç theksoi famullitari i Stubllës Don Aleksandër Kola, është meshtari i 21-të që ka lindur dhe është rritur në Stubllë, pra pa numëruar meshtarët që kanë lindur në Stubllë e që më pas prindërit e tyre janë shpërngulur nëpër Kosovë. Pra, shugurimi dhe mesha e parë e don Ambrozit përkoi me dy jubile të mëdhenj të Kishës sonë: 160-vjetorit të kthimit të martirëve të Karadakut nga Anadolli, ku ishin persekutuar në vitin 1846, vetëm pse ishin shqiptarë katolikë; dhe viti madh jubilar i 2000-vjetorit të apostullit të madh që unguillezoi edhe trojet tona ilire, shën Palit. Për të zmadhuar gëzimin e meshtarit të ri nga Shqipëria, kishte ardhur edhe ipeshkvi i Rrëshenit, Mons Kristofor Palmieri, me disa meshtarë dhe 40 mysafirë të tjerë në krye me kryetarin e bashkisë së qytetit.

Mesha solemne, në kishën famullitare të shën Jozefit, të përgatitur me shumë shije nga motrat vincenciane, filloi në orën 11. Para meshës ishin disa poezi të fëmijëve, të përgatitura enkas për

këtë rast. Pastaj meshtari i ri në bashkëmëshim me disa meshtarë, e mes dy shaxhallarëve të vet Don Marjanit dhe don Albertit, filloi meshën e vet të parë duke ia kushtuar Zotit për të gjithë ata që i ndihmuan në rrugën e meshtarisë, sidomos për gjiysherit e tij që kanë kaluar në amshim.



Don Ambroz Demaj me familjarët e tij meshtarë

Në pretkun e rastit, ish famullitari i Stubllës Don Rok Gjonleshaj ndër të tjera tha: *Para 2000 viteve Krishti e ka filluar në tokë punën të cilën ti duhet ta vazhdojë, në një pjesë të Shqipërisë, në Mirditë, e cila padrejtësisht ka vuajtur dhe është persekutuar gjatë historisë. Mos harro: Krishti*

*është meshtari i parë dhe i vetëm, çdo meshtar është i shuguruar i Tij, meshtar në meshtarinë e Tij, nëpër të cilin Ai e shpëton botën, ia jep falën e vet, korpin dhe gjakun e vet, si dhe të vërtetën dhe dashurinë e vet...Sot duart tua meshtarake, të posa shuguruara, do ta bartin bostën – Krishtin, kujtimin e gjallë të flisë së Tij – të shëlbimit tonë. Që nga sot je nisë në udhëtim me Krishtin, je i punësuar i Tij, dhe ti nuk do të marrësh e as nuk guxon të japësh dorëheqje. Jeta me Krishtin, jeta pranë Krishtit, jeta për Krishtin është jeta jonë. Meshtar i dashur, nga sot nuk je njeri si të tjerët, sepse ti ke zgjedhë të jesh rojtar, dritëbartës, porosi e gjallë e Krishtit... E ke zgjedhë si dhe me kënd do të udhëtosh në jetë. Zoti ta ka dhuruar vetën ty. Ktheja dhuratë vetën tënde. Vetëm jeta e jetuar për të tjerët vlen të jetohet' (Einstein). Zoti ynë këtë e ka dëshmuar, është bërë njeri që të jetojë për njerëz. Ja ideali i jetës meshtarake, ja ideali i jetës sate, përfundoi don Rroku. Kori i kishës me këndim të bukur ia shtoi solemnitëtin meshës.*

Pas meshës u shtrua dreka familjare në restorantin Mendi në

Viti, ku ishin të pranishëm më tepër se 400 mysafirë. Programin me shumë shije e udhëhoqi axha i meshtarit të ri, don Marjani. SHKA Zëri i Karadakut nga Stublla pati disa paraqitje mjaftë interesante dhe programi tjetër i larmishëm, i përgatitur nga m. Zoje Përlaska, e shtoi solemnitëtin e drekës, të përgatitur nga familja.

Don Ambrozi me plotë të drejtë e zgjodhi për moto të jetës meshtarake fjalët e shën Palit: *Jetoj, por jo më unë, në mua jeton Krishti!* (Gal 2, 20).

Siç e theksoi edhe predikatori, meshtari është dora e zgjatur e Krishtit dhe prania e gjallë e Tij në botë. Don Ambrozi, porsì shën Pali, tregoi një vullnet të jashtëzakonshëm për të arritur qëllimin jetësor, të jetë meshtar i Krishtit dhe në shërbim të Tij, Urojmë që porsì shën Pali në përfundim të jetës së vet të thotë: *Luftën e mirë e luftova, vrapimin e kreva, fenë e ruajta. 2 Tim 4,7.*

Meshtarit të ri i dëshirojmë shëndet dhe jetë të gjatë e të frytshme në Vreshtin e Hyjit.

## Thirrjet shenjte në familjen Demaj

Vlen të theksojmë se nga familja Demaj e Stubllës përveç meshtarit të ri, janë edhe don Marjani dhe don Alberti, pastaj motra Ozana, françeskanë. Dy vajzat e axhës, motra e parë nga Stublla

m. Katarina dhe m. Angella, dy kushërirat tjera, m. Miroslava dhe m. Antoneta, françeskane, dhe meshtarët tjerë, djali i hallës don Marjan Marku dhe dy djemtë e hallës Don Viktor dhe don Mikel Sopi. Nga kjo familje, në mesin e martirëve të Karadakut, ishin 12 anëtarë të kësaj familjeje, vetëm 2 u kthyen të gjallë. Pra, në këtë familje më së miri dëshmohet fjalia e shën Ireneut: *Gjaku i martirëve, fara e të krishterëve!* (Don Albert Demaj)

**Ambroz Demaj, u lind më 8. 1. 1979 në Stubllë, nga prindërit Kola dhe Regjina, e lindur Ramaj. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, për të vazhduar pastaj në seminarin dioqezan në Prizren. Për studimet teologjike në vitin 1998 shkoi në Zagreb tek jezuitët, për të vazhduar më pas në Rjekë të Kroacisë. Pas mbarimit të studimeve në vitin 2006, është paraqitur si kandidat ne dioqezën e Rrëshenit, ku edhe është pranuar nga Imzot Cristofor Palmieri. Pas një përvojë dy vjeçare, një vit në famulli dhe një vit në seminarin ndërδιοqezan në Shkodër, më 24 qershor 2008, është shuguruar për xhakon në Katedralen e Rrëshenit, ndërsa më 8 nëntor 2008, është shuguruar për meshtar në Rrëshen, nga Imzot Cristofor Palmieri.**

## Shugurohet xhakon don Marjan David Ukaj

Më 8 nëntor 2008, në Piacenza të Italisë, studenti i teologjisë së Ipeshkvisë së Kosovës Marjan Ukaj, nga familja e Stubllës, ka pranuar shugurimin e xhakonatit nga ipeshkvi i Piacenzës mons. Gianni Ambrosio.

Marjani, në shenjë falënderimi ndaj Kishës së Piacenzës, kishte vendosur që shugurimin xhakonal ta bëjë në këtë vend për të nderuar dhe falënderuar këtë Kishë për të gjitha të mirat dhe angazhimet që Ipeshkvia e Piacenzës kishte bërë në përgatitjen e tij shpirtërore, intelektuale dhe kulturore.

Vetë Ipeshkvi i Piacenzës Gianni Ambrosio dhe famullitari i famullisë don Franco Ca-

PELLI, ku Marjani kreu përvojën pastorale për disa vite, disa ditë para shugurimit kishte ftuar tërë Kishën e Piacenzës në lutje për Marjanin në mënyrë që Zoti ta ndihmojë, ta bekojë dhe ta shenjëtojë vendimin e tij të shenjtë drejtë rrugës së meshtarisë.

Në mbrëmjen e së premtes, pra më 7 nëntor, familja ku Marjani ushtronte përvojën pastorale, kishte organizuar një takim lutjeje me të rinjtë e famullisë pikërisht për Marjanin, prania e madhe e të rinjve, miqve dhe dashmirëve të Marjanit, në këtë takim urate ishte befasuese, gjithë jo e zakonshme në famullitë italiane. Kështu u shpreh vetë fa-

mullitari i kësaj familje.

Mes uratës, këngëve, heshtjeve të njëpasnjëshme dhe dëshmi-së që Marjani bëri mbi thirrjen e vet, takimi zgjati më shumë se një orë. Në dëshminë që Marjani bëri, mes tjerash, dukshëm theksoi rolin e uratës dhe edukimin familjar si dy gjëra që më së shumti kishin kontribuar në përcaktimin dhe përf forcimin e thirrjes së tij në meshtari.

Ditën e nesërme, pra më 8 nëntor ditë e shtunë, prania e familjarëve dhe fafresit të gjerë që kishin ardhur nga Kosova, Zvicëra dhe nga vende të ndryshme të Italisë, i mbushën korridoret e mëdha të atij Kolegji të mrekullueshëm, ku Marjani kishte studiuar për pesë vite. Prania e prindërve dhe të afërmeve, miqve dhe dashmirëve, e bëri edhe më madhështore atë ditë të paharrueshme nëntori përplot me diell dhe ngrohtësi, sikurse të ishte një ditë e bukur maji.

Në mesditën e vonshme të së shtunës, nga Kolegji u drejtua drejtë famullisë për të marrë pjesë në meshën e shugurimit xhakonal të Marjanit. Para orës 18:00 kur duhej të fillonte mesha shenjte, Kisha edhe pse e madhe, dukej e vogël për të pranuar

numrin e madh të besimtarëve, të meshtarëve, rregulltarëve dhe seminaristëve që kishin ardhur për t'iu bashkangjitur gëzimit të Marjanit. Në mesin e shumë meshtarëve ishin të pranishëm edhe meshtarët tanë si: famullitari i Stubllës don Aleksander Kola, don Marjan Ukaj dhe vëllai i të shuguruarit don Anton Ukaj. Ipeshkvi në pretkun e rastit foli për rëndësinë e madhe të kushtimit apo të shugurimit si dhe uroj që xhakoni i ri të jetë një vegël e Zotit në shërbim të Kishës dhe të popullit.

Në përfundim të meshës një djale i ri, në emër të gjithë famullisë, në pika të shkurta i numëroi etapat më të rëndësishme të jetës së xhakonit të ri, duke filluar nga fëmijëria e deri në ditën e kushtimit të tij dhe në fund në emër të të gjithëve ia uroi të gjitha të mirat dhe bekimet e Zotit xhakonit të ri don Marjanit.

Pas sofrës Hyjnore, famullia, falë angazhimit të shumë të rinjve dhe prindërve, kishte përgatitur sofrën vëllazërore, ku gjithë të pranishmëve iu dhua mundësia që të gëzohen me xhakonin e ri dhe familjen e tij, duke i cakërruar gotat dhe duke i uruar xhakonit të ri paqe, shëndet, bekim dhe dashuri.

Për të gjitha ato momente të bukura dhe të shenja e në mënyrë të veçantë për dhuratën e kushtimit të vëllait tonë Marjanit, e falënderojmë dhe e bekojmë Zotin dhe gjithashtu i lutemi Zotit tonë Jezu Krishtit dhe nënës sonë qiellore Virgjërës Mari që xhakonin e ri ta ruajë, ta ndihmojë dhe ta bekojë në rrugën e shenjtë të tij. Urime!

(Avgustin David Ukaj, Zvicër)

**Don Marjan David Ukaj ka lindur në Stubllë të Epërme më 4. 9. 1983. Është i katërti prej dhjetë fëmijëve. Shkollën fillore dhe dy vitet e para të gjimnazit i ka kryer në vendlindje. Pas një mendimi dhe meditim të thellë, në vitin 2000 filloi seminarin e vogël në Prizren dhe aty përfundoi dy vitet e tjera të gjimnazit. Në vitin 2003, me pëlqimin e ipeshkvit mons. Mark Sopi, Marjani që dërguar në Fakultetin Teologjik në Piacenza të Italisë.**

**Pas përfundimit të studimeve, më 8 nëntor 2008, pranoi shugurimin e xhakonatit, ndërsa më 2 gusht do të kremtojë meshën e parë në vendlindjen e tij në Stubllë të Epërme.**



Xhakoni i ri Don Marjan Ukaj në të majtën e ipeshkvit të Piacenzës



# Kisha dhe Islami

## Forumi katoliko-islamk

Nga 4 deri 6 nëntor 25 studiues katolikë e 25 myslimanë u takuan në Vatikan për të studiuar një bashkëpunim mes katolikeve (1,18 miliard besimtar në botë) e myslimanëve (1,14 miliard besimtar në botë). Tema e përbashkët e ka iniciativën para dy viteve. Pas fjalimit të Papës Benediktit XVI në Regensburg më 12 shtator 2006, bota islame reagoi me shumë dhunë nga paraqitja e Papës për të njohur raportin me Zotin që implikon edhe arsyen dhe përjashton dhunën. Shumë prej reaksioneve, fryt i injorancës, që gjykonin se fjalimi ngrehte dhe promovonte përçarje dhe gjykonin vetëm mbi atë që është thënë pa e pasur parasysh rrjedhën historike (shpesh në formë të shtrembëruar), reguan gjitha agjencitë e medieve botërore edhe me protesta të ndryshme.

Pikërisht, duke u nisur nga fjalimi në Regensburg, 38 mësues islamikë e kanë dërguar letërën e parë më 13 tetor 2006, e një vit pas letresë se dytë (e nënshkruar nga 138 pjesëtarë e më pastaj janë edhe shumë të tjerë) për të kërkuar një terren të përbashkët të bashkëpunimit mes krishterimit e islamizmit.

Më 19 nëntor 2007, Benedikti XVI i ka përgjigjur letresë se 138 nënshkruese duke hapur mundësinë e bashkëpunimit në fusha të ndryshme. Më 12 dhjetor 2007, një letër Kardinal Tharciso Bertone e Princit Jordan Ghazi bin Muhammad bin Talal, pranon të hapë një bashkëpunim e dialog. Në përfundim palët kanë dëshmuar pëlqimin për krijimin e një Forumi katoliko-islam "për të zhvilluar me shumë dialogun mes katolikeve e islamit". Pikërisht ky Forum takohet për të parën herë në Romë nga 4 deri 6 nëntor 2008.

### Kisha dhe Islami

Një fillim i mirë në Forumin katoliko-mysliman në Vatikan. Sfidat e përbashkëta ishin të shumta, paragjykimet, shekullarizmi, materializmi, relativizmi, liria fetare, indiferentizmi, fundamentalizmi. Myslimanët kërkojnë ndihmë të krishterëve të dalin nga islamofobia. Pas shumë vjetësh e shekuj vërshtësish, ky është takimi i parë në nivelin ndërkombëtar, të bashkuar nga tërë bota: bota arabe, afrikane, aziatike, evropiane, amerikane, oqeanike. Edhe pjesëtarët katoli-

kë ishin nga të gjitha kontinentet e ndryshme. Këshilli për Dialog ndërjetar e ka studiuar hollësisht këtë takim, por edhe nga të dy palët ishin edhe gratë të pranishme në kuadër të punëve.

### Frymë vëllazërore

Elementi më i rëndësishëm për ta cekur është klima vëllazërore, respekti reciprok për tërë kohën, edhe në momentet publike dhe ajo e paraqitjeve të temave, shqyrtimet e debatet. Kjo klimë është favorizuar nga Kardinali Jean-Louis Tauran dhe nga Myftiu i Sarajevës Mustafa Qeriq që të dytë kanë insistuar me fjalët "vëllazër e miq".

Edhe programi ka ndihmuar shumë në këtë drejtim. Ka ndihmuar të perceptohen dy vizione të dallueshme por që kërkojnë të takohen. Tërë puna e ditës ishte me intervenime të ndryshme, komente e pyetje nga njëra e tjetra palë. Të gjithë iu kanë përmbytur

reciprok. Disa kishin frikë nga këto tema, sepse ishte rrezik të ngrihen probleme brenda vetë islamit, duke përfshirë edhe lirinë fetare, dëshminë publike, misionin...etj.

Por në fund ishin të gjithë dakord të ballafaqohen temat në nivelin filozofik, për t'i bazuar këto tema fetare, si në nivelin praktik dhe për të sugjeruar disa aplikime. Edhe kjo ka dhënë frytet e veta, ku islamikët i kanë paraqitur vështirësitë e tyre në pranimin e barazimit mes njerëzve, dinjitetin e përbashkët, lirinë për të dëshmuar fenë personale dhe pika tjera të jetës praktike e shoqërore.

Disa islamikë të pranishëm, e kanë shprehur zilinë ndaj të krishterëve për reformat e bëra gjatë historisë, të thella shpirtërore e morale, mbi lirinë dhe barazinë që është sot shembull për gjitha religionet botërore, sidomos në aspektin e ndarjes

Nga këtu kanë biseduar edhe mbi lirinë fetare, një temë e ndryshme, që është prekë pakë e më shumë maturi dhe që është miratuar me pranimin e nënshkrimit të dokumentit përfundimtar.

Në deklaratën e përbashkët, në pikën e pestë thuhet: "ka edhe të drejtë individit e bashkësia të praktikojë religionin e vet në mënyrë private e publike". Këtu ka pasur vështirësi dhe interpretimet e ndryshme nganjëherë ishin të papërcaktueshme deri në deklaratën përfundimtare, sepse disa islamikë të pranishëm kanë thënë "Nëse e shtoni këtë fjalë na gëton në vështirësi të mëdha, sepse liria fetare në vendet tona është e drejtuar nga ligjet shtetërore. Si mundemi të shpallim një dokument, i cili shkon kundër ligjeve të shtetit? Është rreziku të klasifikohemi e të përjashtohemi nga vetë shoqëria jonë", dhe disa të tjerë kanë sugjeruar të shlyhet fjala "privatisht e publikisht".

### Sfidat e përbashkëta: modernizimi pa Zotin

Tema më e trajtuar ishte shekullarizimi drejt së cilës hapet një mision i përbashkët. Për disa intervenues islamë, shekullarizmi i botës është shqetësues, ndaj të cilit duhet reaguar dhe për këtë kërkohej reagim i përbashkët. Është rreziku të bihet në vizionin fundamentalist, dhe kërkohej prej qeverive të garantojnë patjetër lirinë fetare.

### Liria fetare

Dy religionet në takim kanë konkorduar të sjellin mesazhin dhe të bëjnë thirrje të shpallin jetën misionare të lirisë fetare. Dhe për t'i përdorur mjetet favorizuese për ta kundërshtuar dhunën, përndjekjet që bëhen për bindje fetare. E vërteta duhet t'i këtë të garantuara të gjitha të drejtat. Forumi ka përfunduar me një apel të përbashkët mbi: "Adburimin e Zotit me dashuri, dashuri ndaj të afërmit, dinjiteti dhe barazimi mes burrit dhe gruas...! Zoti kërkon të bashkëpunojmë se bashku në emër të viktimitave të pafajshme, varfërisë, sëmundjeve, padrejtësive e dhunës".

### Përfundimi

E gjithë kjo mund të përmblidhet në tri pika:

- që të vazhdohej për të kontribuar në vetëdijen fetare, lirinë dhe respektin reciprok;
- që në fund të nxirren dokumente të përbashkëta, që të përhapen dhe të shpallen për sa është e mundshme dhe
- që t'i jepet autoritet maksimal deklaratave e dokumenteve që nxirren.

Nga ana katolike është më e lehtë: mjafton që kardinali i deleguar të bëjë fjalën. Nga ana islamike, duhet të jetë një akordim mes personaliteteve fetare e politike islamike. Ligjet që i kufizojnë lirinë fetare, janë të bëra nga qeveritë islamike e jo nga dijetarët islamikë. Që pasi të jetë përfunduar një takim i tillë, të informojnë edhe qeveritë mbi risitë dhe akordet e arritura në nivel ndërkombëtar, t'i informojë edhe sektet e asociacionet islamike, dhe të jetë e paraqitur edhe në Konferencën Islamike Botërore. Nëse nuk bëhet kjo, atëherë ky bëhet vetëm një takim pa fryt për të mirën e njerëzimit. Autoriteti i dokumentit është thelbësor.

(Don Pal Tunaj)



rrugallave dhe mënyrës se intervenimeve. Pra, gjithë ky takim ishte fryt vëllazëror e miqësor i shkëmbimeve reciproke për një botë sa më të vërtetë e të lirë në frymën fetare e shoqërore.

Një pikë tjetër që vlen të ceket, është kualiteti dhe serioziteti i pjesëmarrësve, i nivelit të lartë nga pikëpamja intelektuale e shpirtërore. Kjo i ka dhënë një rëndësi të lartë dialogut, sidomos intervenimeve të ndryshme dhe në veçanti relacionit të Seyyed Hossein Nasr (filosof iranien e profesor në Shtëpi të Bashkuara të Amerikës).

### Vështirësitë

Dialogu nuk i ka fshehur edhe vështirësitë. Për takim ishte zgjedhur tema: "Dashuria e Zotit dhe dashuria e të afërmit", dhe ishin të gjithë një zëri që të bëhen konfrontime e argumentime teologjike që nga dita e parë. Në ditën e dytë temat ishin ato mbi dinjitetin njerëzor e respektin

së shteti nga feja, që shpesh këto sjellin luftërat, diskriminimet, përndjekjet, racizmin dhe shumë padrejtësi të tjera. Kjo mendohet të jetë një analizë e vlefshme edhe pse jo e mjaftueshme. Dallimi mes fesë e politikës nuk është vetëm fryt i luftërave historike, por qysh prej fillimit ajo ka bazën në Ungjill, ku Jezusi refuzon të sillet si një lider politik e social. Ndërsa në kontekstin islam dhe fiseve arabe në shekullin VII, e ka shtyrë Muhametin të bëjë zgjidhje social-politike.

Ky pra është një kontribut për të gjithë, edhe për shoqëritë përrëndimore, që shkojnë drejt një ateizmi praktik. Shumica prej tyre e kanë cituar Papën ndaj qëndrimit që e ka në këtë shoqëri dhe kontributin që e jep me intervenimet dhe mësimet e tij, ku shekullarizmi e materializmi i bashkon katolikët e myslimanët.

Dhe kanë shprehur mendimin se shekullarizmi e meriton një takim e debat të veçantë.

Por zbutjen dhe zhblokimin ia dha me deklaratën e tij Myftiu i Bosnjes e Hercegovinës Mustafa Qeriq që e ka ballafaquar këtë me deklaratën mbi të drejtat e njeriut që është nxjerrë nga OKB, e shumë qeveri islamike e kanë nënshkruar atë Deklaratë.

Kjo deklaratë është përkthyer në të gjitha gjuhët për ta përhapur dhe aktualizuar, dhe për t'i sensibilizuar qeveritë përkatëse, duke i kërkuar edhe ndryshimin e ligjeve diskriminuese.

Një mënyrë tjetër, për ta bërë të frytshme këtë forum është edukimi i gjeneratave të reja në respekt e tolerancë, si në tekstet shkollore dhe publike të tjera. Të gjithë ishin dakord, se nuk mund të vazhdohej të transmetohen gabime, që kështu librat dhe historia të flet për të krishterët dhe myslimanët në frymë respekti e bashkëpunimi dhe bashkëjetesë. E kjo temë është propozuar që të jetë një nga temat kyçe e forumit të ardhshëm.

# Bibla

## Fjala e Zotit e cila duhet jetuar

■ SHKRUAN:  
Don jeton THAQI

Prej datës 5 deri më 26 tetor, në Romë është mbajtur Asambleja e Përgjithshme, e zakonshme, e 12-ta me radhë, e Sinodit të ipeshkvijve në trajtimin e temës: Fjala e Zotit në jetën dhe në misionin e KISHËS. Qëllimi kryesor i këtij Sinodi ka qenë dhe mbetet, që besimtarët ta takojnë fjalën e Zotit - në Jezu Krishtin, i pranishëm në Shkrimin e Shenjtë dhe në Eukaristi. Mu për këtë edhe Sinodi i mëparshëm, i cili u mbajt para tri viteve, kishte temë trajtimi Eukaristinë. Prandaj, kisha katolike e drejtuar prej Papës, zëvendësit të shën Pjetrit, dhe ipeshkvijve, pasardhës të apostujve, nëpër mjet këtyre dy sinodeve ka synuar që të tregojë lidhjen e ngushtë ndërmjet Fjalës së Zotit dhe Eukaristisë. Pra, të gjithë ne, të cilët jetojmë si të krishterë dhe si besimtarë, dhe që jemi besimtarë e mileniumit të tretë të krishterimit; duhet të jemi të bindur (këtë e thotë bindshëm ky sinod) që detyra primare jona është të ushqehemi me fjalën e Zotit, për ta bërë sa më efikase urgjencën apo nevojën e ungjillëzimit në kohën dhe në situatat tona konkrete. Thotë Papa Benedikti i XVI *"Është më se e nevojshme që këtë përvojë ta sjellim në çdo bashkësi kishitare dhe që fjala e dëgjuar të konkretizohet në gjeste dhe vepra dashurie"*. Edhe ky shkrim ka për qëllim thjesht t'i ndihmojë besimtarit, apo lexuesit, në afrimin dhe në familjarizimin e shkrimit të shenjtë, Biblës.

### Informacione të përgjithshme bazilare

Fjala *Bibël* rrjedh prej fjalës greke *βιβλία* = *biblia*, ose në shumës *biblon*, që do të thotë *libra*. Bibla, pra, apo siç quhet edhe ndryshe, libri i librave, janë shkrimet e shenja të hebraizmit dhe të krishterimit. Ndahet në dy pjesë: Besëlidhja e Vjetër dhe Besëlidhja e Re. Besëlidhja e Vjetër përbehet prej shkrimeve të

shenja të popullit të zgjedhur të Izraelit dhe në origjinë ka qenë e shkruar në gjuhën hebraike, me përjashtim të disa pjesëve në aramaishite. Ndërsa pjesa e dytë e nominuar Besëlidhja e Re, është e shkruar në greqishten e vjetër dhe flet për historinë e Jezu Krishtit dhe të zanafillës së krishterimit. Është përkthyer, në

sa Bibla jo vetëm që përmban fjalët dhe urdhërimet e Zotit, por ajo është tërësisht e shkruar nën frymëzimin e Hyjit të gjithëpushtetshëm. Për këtë arsye mund të themi që Bibla është libër i Zotit, të cilin ia ka dhuruar njeriut për ta drejtuar drejt jetës së amshuar. Si në Besëlidhjen e Vjetër, ashtu edhe në Besëlidh-

të Zotit, duke treguar raportin-lidhjen e Hyjit me njeriun të një përudhe të gjatë përafërsisht pesë mijë vjet. Është vërtet e vështirë për njeriun të kuptojë apo të akceptojë Atë, të cilit ditët e tij nuk kanë as fillim as mbarim, sepse Zoti është i përsosur. Edhe pse është e vërtetë që ne mund ta perceptojmë, me gjithë atë për-

tek ai do të vijmë dhe tek ai do të banojmë" (Gjn 14, 23). Kjo është edhe arsyeja që Zoti na urdhëron të përgatisim zemrën tonë për ardhjen e Tij: *"Zemra ime është gati, o Hyj, gati është zemra ime"* (Ps 57, 8). Kështu shohim qartazi që Bibla në tërësi, në mënyrë ndoshta misterioze, na e zbulon Hyjin dhe na përgatit për ta pranuar në zemrat tona, që të kemi mundësi, tani e tutje të jetojmë me të, duke u përgatitë paraprakisht për atë që do të jetë në fundin e kohëve, kur Zoti do të na zbulohet dhe do ta takojmë ballafaqë e do të jetojmë përgjithmonë me të.


### Lexusi përballë Biblës

Ekzistojnë dy mënyra të leximit: e para është kur lexuesi e vë vetveten dhe mendjen e vet si patron të atij teksti që lexon dhe me përpjekjet që ta nënshtrojë domethënien e tekstit përballë kuptimit të tij, duke e konfrontuar me kuptimin apo akceptimin e të tjerëve; dhe tjetra mënyrë, kur lexuesi i nënshtrohet me mendje e me zemër domethënies dhe kuptimit të atij teksti, duke e konsideruar tekstin drejtësi apo si kriterin më të lartë.

Metoda e parë është e përshatshme për çdo libër në botë, qoftë ai shkencor apo i literaturës botërore. Metoda e dytë është e nevojshme në leximin e Biblës. Metoda e parë na shpie tek zotërimi i njeriut mbi natyrën, ndërsa metoda e dytë na ngre tek zotërimi i Hyjit si Krijues i gjithëdijshëm dhe i gjithëpushtetshëm. Por në qoftë se njeriu shkakton konfuzion me këto dy metoda, e humb potencën e të dyjave.

### Nxënësi dhe Bibla

Kur qyteti i Milanos mbeti pa ipeshkëv, mbeti pa bariun e tyre shumë të dashur - shkruan shën Augustini - populli i tërë qante e vajtonte, sepse e kishin humbur "njeriun e fjalës dhe të sakramentit". Ndoshta kuptohet me mirë ky fakt, nëpërmjet një ngjarjeje, të cilën e gënjehet shpesh në jetën e vet shën Augustini: një ditë shkon te ipeshkvi i vet, prej



“ Bibla, apo fjala e shkrimit të shenjtë, është “e frymëzuar”. Çka do të thotë kjo? A do të thotë vallë që vetëm në një moment të historisë Shpirti i Shenjt ka intervenuar mbi shkrimtarin e shenjtë dhe e ka shtyrë apo frymëzuar për të shkruar (gjë që është shumë e vërtetë), apo nuk do të thotë që Shpirti i Shenjtë vazhdon edhe sot e kësaj dite të jetë i pranishëm në këto fjalë? ”

tërësi apo vetëm në disa pjesë, në më shumë se 1500 gjuhë të ndryshme të botës. Bibla është libri më i shpërndarë, më i pranishëm dhe më i lexuar në botë. Gjithashtu, edhe influenca apo ndikimi i këtij libri të shenjtë në histori, në kulturë, në literaturë dhe në arte, është e papërkshues.

### Bibla përballë lexuesit

Bibla është një libër i ndryshëm prej librave tjerë: librat tjerë janë të shkruar prej njeriut, ndër-

jen e Re, edhe pse fjalimet, diskursat, ngjarjet dhe historitë e ndryshme tregojnë dhe koncentrohen mbi njeriun, në të prapë se prapë është i fshehur Zoti. Në fakt, Bibla na e përshkruan Zotin dhe na e zbulon nëpër mjet ngjarjeve apo ndodhjeve. Por një përshkrim komplet të Hyjit nuk na jepet mundësia ta kemi, deri sa jetojmë në këtë botë, ku njeriu është i kufizuar. Dhe me vështirësi Bibla dëshiron të na japë një imazh apo figurë të thjeshtësuar

sosmëria e tij si dhe veprat e tij mbetën të pakapshme.

Qëllimi i Biblës është ta përgatisë intimisht njeriun që ta pranojë Zotin, qoftë duke na e zbuluar Atë, qoftë duke na bërë që ta njohim. Ndoshta ndonjëherë duket që është njeriu që shkon drejt Zotit, por e vërteta e madhe qëndron se Zoti vjen drejt njeriut si i dashur dhe si Atë me plot gëzim dhe dashuri: *"Nëse ndokush më do, ai do të më mbajë fjalën, Ati im do ta dojë,*

“Qëllimi i Biblës është ta përgatisë intimisht njeriun që ta pranojë Zotin, qoftë duke na e zbuluar Atë, qoftë duke na bërë që ta njohim. Ndoshta ndonjëherë duket që është njeriu që shkon drejt Zotit, por e vërteta e madhe qëndron se Zoti vjen drejt njeriut si i dashur dhe si Atë me plot gëzim dhe dashuri.”



të cilit ishte pagëzuar dhe kishte pranuar fenë e krishterë. I afrohet derës, troket dhe askush nuk përgjigjet. Atëherë me kujdes të madh e hap derën dhe e sheh, e vëren ipeshkvin e Milanos, që më vonë do të jetë shën Ambrozi, në gjunjë, në prehrin e tij kishte librin e shkrimit e shenjtë dhe ishte i thelluar në lutje dhe në meditim të fjalës së Zotit. Ky “spektakël” e befasoj shën Augustinin, i cili nuk pati guxim ta shqetësojë dhe në majë të gishtërinjve largohet nga dhoma e tij. Një bari, ipeshkëv që lutet dhe mediton në këtë mënyrë, bëhet jashtëzakonisht efikas në shpalljen e fjalës, kështu që edhe populli i Milanos kishte të drejtë për ta qarë e vajtuar. Prandaj shembulli i shën Ambrozit duhet t’u shpërbejë të gjithë ipeshkvijve, meshtarëve dhe besimtarëve që të duan dhe të meditojnë mbi fjalën e Zotit me të njëjtën dashuri.

#### Fjala e Zotit mjet bashkimi dhe komunikimi

Fjala në përgjithësi është një mjet bashkimi dhe komunikimi dhe shpeshherë është një flakë që bashkon dy universet të brendshme, kur ajo është e vërtetë. Por aq më tepër, kur kemi të bëjmë me fjalën e Zotit: “Në fillim ishte fjala e fjala ishte në Hyjin e Fjalë ishte Hyj” (Gjn 1,1). Zoti flet, komunikon dhe, duke folur, Ai i dhurohet njeriut. Zoti i Biblës është një Zot që flet, që komunikon dhe është Ai i pari që merr iniciativën dhe komunikon me njeriun: nuk është sikur idhujt memecë që nuk kanë gojë për të folur. Ai, me anë të fjalës, shkon drejt njeriut dhe i dhurohet tërësisht. Do të thuhej ndryshe, me anë të një termi filozofik që fjala e Tij është auto-implikuese, në të cilën Ai e vë në “lojë” vetveten. Nuk është një “flatus vocis”, një erë e zërit apo një zë sipërfaqësor, por Fjala e Tij rrjedh prej lartësisë dhe kërkon një botë tjetër personale. Duhet të arrijë zemrën tonë, brendinë tonë.

Një ditë Zoti i tha Ezekielit kështu: “Biri i njeriut, të gjitha

fjalët që po t’i them, pranoi në zemër e dëgjoji me veshë” (Ez 3,10). Zoti kërkon një zemër që dëgjon. Lypet, pra, një lidhje apo një kontakt direkt ndërmjet organit të dëgjimit dhe qendrës më intime të personit. E pastaj edhe gatishmërinë që ta “vejmë në lojë” edhe në jetën tonë në shërbim të Fjalës së amshuar. Fjala e Zotit ka tingëlluar gjithmonë në gojë të profetëve. Profeti është Ai që flet në emër të Zotit: “mu që drejtuar fjala e Zotit: shko e thuaj...”

Por ka ardhur momenti kur Fjala e Zotit është mishëruar. Atëherë komunikimi nuk ka qenë më indirekt, por direkt. Komunikimi i Jezusit është direkt. Jezusi komunikon fjalët e Zotit, sepse vet Ai është Zot. Është një Fjalë siç thotë në mënyrë të mahnitshme shën Bernardi: “nuk është një Fjalë që dëgjohej vetëm me veshë, por që shihet me sy dhe e prekshme me dorë”. Jezusi është Fjala dhe kështu fjala e Zotit e prek jetën tonë.

#### Jo një libër, por goja e Zotit që flet

Bibla, apo fjala e shkrimit të shenjtë, është “e frymëzuar”. Çka do të thotë kjo? A do të thotë vallë që vetëm në një moment të historisë Shpirti i Shenjt ka intervenuar mbi shkrimtarin e shenjtë dhe e ka shtyrë apo frymëzuar për të shkruar (gjë që është shumë e vërtetë), apo nuk do të thotë që Shpirti i Shenjt vazhdon edhe sot e kësaj dite të jetë i pranishëm në këto fjale? Shën Augustini thotë: “Non enim fecit et abiit, sed ex illo in illo sunt – nuk është që i krijoi

dhe u largua prej tyre, por në fakt prej tij u krijuan dhe në të ekzistojnë, në të qëndrojnë”. Pra ka shumë të drejtë shën Augustini, kur thotë, se nuk është që Zoti gjërat i ka krijuar dhe është larguar prej tyre. Krijimi ekziston, sepse Zoti vazhdon të krijojë, vazhdon ta mbajë dhe të kujdeset për të. Një gjë e tillë a nuk vlen edhe për fjalën? Kjo fjala tingëllon, sepse Zoti na drejton në këtë moment.

Është një fjalë aktuale, e gjallë, prandaj më duhet ta pranoj, ta marr prej buzëve të tij. Këtë e kërkon edhe “DEI VERBUM” konstitucioni konciliar mbi fjalën e Zotit. Këtu nuk kemi të bëjmë me leximin e një libri, por më dëgjimin e Dikujt, do të thotë të një personi. Kjo theksohet shumë qartazi edhe nga liturgia, kur ajo kremtohet si duhet. Kjo do të thotë, të përcjellësh lektorin me dy qirinjë në procesion, pastaj ta kemosh atë sikur kam përjetuar në disa kisha, të vëhet fjala e Zotit në altar dhe të ndërrohet sikur është traditë e protestantëve apo e ortodoksëve. E di që të gjitha janë vetëm shenja, por që kanë një domethënie jashtëzakonisht të madhe. Pastaj kur në fund të shpalljes së ungjillit meshtari thotë: “Fjala e Zotit” e populli i përgjigjet “Lavdi ty o Krisht!”, është e njëjta shprehje që ajo gruaja e ungjillit i thotë Jezusit: “Ndërsa ai po fliste për këtë gjë, një grua në mes të turmës e çoi zërin e i tha: “Lum krahavori që të mbarti e gjinjtë që thithel!” (Lk 11, 27). Është një klithmë admirimi që rrjedh prej zemrës pasi që Zoti na ka drejtuar gjëra të mrekullueshme.

Sepse Ai është i pranishëm në fjalën vet: “është Ai që flet kur lexohet Shkrimi i shenjtë. (Sacrosantum Concilium 7). (Nuk kemi të bëjmë me një libër: libri është vetëm një mjet. Është dikush që flet. Në ritin armen, xhakoni në liturgji thotë kështu: “Jini të kujdesshëm” dhe populli përgjigjet: “Është Zoti që na flet”. Nëse fjala është e gjallë dhe vepruese, atëherë është i mundur një dialog, kështu që shpeshherë edhe ndër ne, etërit e Kishës, por edhe në Mesjetë, thuhej kështu: Kur e lexon Biblën, është Zoti që të flet, ndërsa kur lutesh, je ti që i përgjigjes.

#### Të lumët ata që e dëgjojnë

Zoti bisedon dhe unë e dëgjoj dhe nëpërmjet fjalës hy në bashkim të plotë me të. Të shohim momentet esenciale të këtij dëgjimi:

#### a) Dëgjimi i fjalës

Një autor prej Sirisë i shekullit IX, i quajtur Joseph Busnaya, e përshkruan në letërën e tij biblike mënyrën e dëgjimit të tij ndaj Fjalës së Zotit: “*kërko prej Zotit t’i ndriçosh sytë e inteligjencës dhe të shpirtit tënd, për të qenë i aftë të perceptosh forcën e thellë të fshehur në fjalën e tij. Dhe duke e respektuar në veçanti ungjillin, lutju kështu: Krisht, Zoti i ynë, unë që jam i padenjë, të shtrengoj fort në duart e mia duke e shtrenguar dhe përfaqësuar ungjillin tënd. M’i drejto, të lutem, fjalët e jetës dhe të ngushëllimit...*” Ky tekst na ndihmon të kuptojmë që duhet vazhdimisht ta nderojmë edhe librin në të cilin është shkruar fjala e Zotit.

Fjala e Zotit është transce-

ndente dhe është shumë normale që kjo duhet të shprehet nëpërmjet shenjave. Prandaj mund të themi, që, nëse është Ai që më flet, nëpërmjet fjalës së tij, kur e lexoj unë duhet ta dëgjoj. Duhet ta dëgjoj me zemër, sepse prej zemrës së Zotit rrjedh ajo fjalë e frymëzuar. Thoshte kështu shën Gregori i madh: mësohu ta njohësh zemrën e Zotit nëpërmjet fjalës së tij”.

Fjala, qoftë ajo e predikimeve të meshtarëve apo qoftë ajo biseda dëshmuuese e besimtarëve, lind nga ky dëgjim me pasion, vetëm atëherë kjo fjalë do ta ketë aftësinë dhe mundësinë me e prekë zemrën e tjetrit. Profeti apo meshtari, ose çdo besimtar, është i vërtetë, kur e ndien fjalën e Zotit si një flakë në eshtrat e tij.

#### b) Pas dëgjimit vjen ruajtja e fjalës

Në ungjill ndonjëherë kemi dëgjuar atë lavdërimin që ia bëjnë nënës së Jezusit e Ai i përgjigjet me këto fjalë: “Madje, të lumët ata që e dëgjojnë fjalën e Hyjit dhe e zbatojnë!” (Lk 11, 28). Dhe me këto fjalë nuk e ka mohuar nënën e vet, por na ka treguar sekretin e shenjtërisë. Maria është ajo që në plotësi e ka dëgjuar, e ka pranuar dhe e ka ruajtur në zemrën e vet fjalën e Zotit. Aq shumë e ka dëgjuar fjalën e Zotit, sa që Zoti mishërohet në krahë të saj.

#### c) Zbatimi i fjalës

Në një vend tjetër në ungjill dëgjojmë këto fjalë: “*Nëna e tij dhe vëllezërit erdhën ta shohin, por s’mundën të afroreshin tek ai prej popullit. E lajmëruan: “Nëna jote e vëllezërit e tu, janë jashtë e dëshirojnë të të shohin.” Ai iu përgjigj: “Nëna ime e vëllezërit e mi – janë këta – që e dëgjojnë dhe e zbatojnë Fjalën e Hyjit.” (Lk 8, 21).* Prandaj ta ruajmë në sikur Maria këtë fjalë dhe ta shtiem në vepër në atë masë që fjala e Krishtit të mishërohet në ne duke sjellë vepra të mira për jetën tonë dhe për jetën e të gjithëve...”



# Shën Jeronimi

## (340 – 420)

■ SHKRUAN:  
Don Marjan DEMAJ

Jeronimi u lind nga prindërit e krishterë rreth viteve 340–350, në Stridon, në kufi të Dalmaci-së dhe Panonisë. Si njëzvetëçar shkoi në Romë për studime. Mësimdhënësi i tij ishte gramatikani i njohur Eli Donati. Jeronimi ishte i interesuar për retorikë dhe klasikë. Vendi çfarë ishte Roma, në atë kohë e përshkrua në vaktet e veta të përditshme. Më vonë Jeronimi me lot për faqe dhe me zemër pendohet.

Ndikim të madh në kthimin e tij, kishin katakombet. Jeronimi shpesh shkonte në to dhe meditonte shumë për vuajtjet dhe salvimet që kishin përjetuar të krishterët e parë. Motiv i martirizimit të tyre ishte Krishti. Më vonë edhe vetë Jeronimi do të motivohet për ta ndjekur atë. Jeronimi u pagëzua në moshën madhore, aty rreth vitit 365, nga vetë papa Liberi. Prej Romës shkon në Trier dhe atje hyn në bashkësinë e asketëve. Arriti që nëpër Evropë të krijojë një miqësi të madhe me njerëz të ndryshëm. Në vitin 373 udhëton në Lindje. Në rrugë për Jerusalem sëmurët rëndë dhe mbetet në Antioki. Posa forcohet dhe merr fuqi fizike, shkon në shkretëtirën Chalkis dhe atje për pesë vite bën pendesë të madhe dhe mëson gjuhën hebraike dhe Shkrimin e Shenjtë. Në atë kohë shugurohet për meshtar nga Paulini, ipeshkëvi i Antiokisë, me kusht që edhe më tutje të mbetet eremit.

Jeronimi kishte dëgjuar për Gregorin e Nazianit si orator i famshëm dhe kështu kërkoi dhe gjen rastin të takohet me të. Kjo ndodhi në Konstantinopojë. Këtu me ndihmën e Gregorit përkthen shumë vepra të Origenit në gjuhën latine. Origenin Jeronimi e çmonte shumë.

Më 382 papa Damasi, duke dëgjuar për veprimtarinë e tij të begatshme, e thërrret në Romë. Papa ia beson Jeronimit shumë punë kishitare, të cilat ai i kreu me shumë sukses. Por pas dy viteve, me vdekjen e papës, e pasi që nuk kishte përkrahjen e të tjerëve, ai prapë kthehet në Lindje.

Jeronimi, që ishte i dhënë pas jetës asketike, në Betlehem hap dy kuvende. Shumë gra dhe burra, duke e parë shembullin e tij të mirë, shkonin pas tij. Në Betlehem përkryhet në gjuhë nga rabinët dhe fillon ta përkthejë Shkrimin e Shenjtë nga

origjinali në gjuhën latine. Në fund të jetës Jeronimi vuan shumë, sepse i dobësohen sytë: nuk shihnte dhe nuk mund të lexonte si duhet.

Megjithatë, shën Jeronimi nuk e la pendën deri në fund të jetës së vet. Zemra e tij e madhe pushoi së rrahuri në vitin 420, pa e kryer veprën e madhe, Komentin mbi Jereminë profet. Trupin e Jeronimit e bartin në Romë në bazilikën e shën Marisë.

Jeronimi ishte i madh, sepse kishte njohuri të madhe. E njihje mirë gjuhën latine klasike letrare, po ashtu gjuhën hebraike dhe atë greke. Jeronimi nuk ishte mendimtar i madh as teolog si shën Augustini, nuk ishte as orator e bari si shën Ambrozi ose si shën Luani, por Jeronimi ishte shkencëtar dhe punëtor i madh. Lirisht mund të themi se pas shën Augustinit ishte më i madhi ndër etërit e Kishës Katolike. Tërë ditën e vet e përdori në përkthim të Shkrimit të Shenjtë.

Si njeri, Jeronimi ishte temperament, ndoshta pse është me prejardhje ilire. “Më fal o Zot për karakterin tim eksploziv, sepse jam dalmat”, rrëfehej shën Jeronimi.

Vitet e fundit Jeronimi kaloi në vuajtje të mëdha. Ishte me shëndet të dobët dhe i verbër dhe i vetmuar. Jeronimi pas shumë luftërave që i sfidoi në jetë, gjeti prehje në paqe te Zoti më 30 shtator të vitit 419 apo 420 nuk është e sigurt.

Në veprën e vet “De viris illustribus” shkruan vetë për veten e tij: “Isha filozof, orator, dhe njohës i mirë i gjuhëve hebraike, greke, dhe latine.”

Po e paraqesim një dialog që kishte me Jezusin foshnje në shtallë të Betleemit ku edhe kaloi një kohë të jetës së vet.

Fëmijë i dashur, si dridhesh? Për shëlbimin tonë, si je i vendosur në këtë shtatë të fortë? Çka mund të bëj për ty?

Jezusi u përgjigj: Jeronim, asgjë nuk dua prej teje! Vetëm këndo: “Lavdi Hyjit në qiell!” “Në malin e ullaive dhe Kalvar do të jem edhe më i mjerrë” Atëherë prapë vazhdon Jeronimi: “Fëmijë i dashur dua të të dhuroj diçka, do të jap të gjitha të hollat që kam.”

Me buzëqeshje ia ktheji Jezusi: “Toka dhe qielli së pari janë pronë imja. Nuk dua paratë tua. Ndaj të varfërve! Ashtu do të pranoj si të më ndihmosh mua.” Por unë dua diçka të bëj për ty, sepse përndryshe do të vdes nga mundimi.” Atëherë ia ktheji Je-

zusi: “Atëherë m’i jep të gjitha mëkatet tua, të gjitha ligështitë e zemrës sate.”

Jeronimi e pyeti: “Çka do të bësh me to?” Jezusi iu përgjigj: “Mëkatet tua do t’i vë në supin tim dhe do t’i bart.”

Jeronimi filloi të qajë dhe vazhdoi: “Jezusi i mirë, merri atëherë mëkatet e mia, dhe më jep atë që do ti.” E përfundoi këtë bisedë me Jezusin: Kush i dhurohet Krishtit mund të vdesë, por nuk do të jetë humbës.

Kisha Katolike e nderon si *doctorem maximum in exponendis sacris scripturis* (si më të madhin

ende librat e Jobit dhe Psalmet, me të cilat ne sot shërbehem dhe të cilat gjenden në Vulgatë).

c) *Përkthimi i Besëlidhjes së Vjetër nga gjuha hebraike*. Këtë përkthim shën Jeronimi e fillon në vitin 390. Ai këtu për këtë përkthim burimor përdor edhe librat e vjetra grekë të Simakut dhe Aquilit.

d) *Përkthimet e etërve të Kishës*:

– In Jeremiam, 28 predikime të Origenit;

– Kronikën e Euzebit;


– De Spiritu Sancto të Didimit të Verbër;

përkthim tekstual, që do të thotë fjalë për fjalë.

### Veprat dogmatike – polemike

a) *Diskutimi në mes të një të djallosuri dhe një fetari*. Ky është një dialog në të cilin Jeronimi i hedh poshtë mendimet e rigoristëve, të cilët thoshin se duhet asgjësuar selitë ipeshkvore dhe ipeshkvijtë, të cilët u treguan të suksesshëm në luftën me arianizmin, në kuptimin se pagëzimi i arianëve është i pavlefshëm, e jo i vlefshëm sikurse mendonin disa klerikë.

“Si njeri, Jeronimi ishte temperament, ndoshta pse është me prejardhje ilire. “Më fal o Zot për karakterin tim eksploziv, sepse jam dalmat”, rrëfehej shën Jeronimi.”



mësues në shpjegimin e Shkrimit shenjtë).

Veprat e Jeronimit mund të ndahen në përkthime, komentime, shkrime, polemika, predikime, letra etj.

1. *Vulgata*, përkthim i Biblës në gjuhën latine.

a) *Rishikimi i Ungjillit*. Kur Jeronimi ishte në Romë në vitin 382, papa Damasi ia beson këtë detyrë që ta bëjë sipas Septuagintës (LXX).

b) *Rishikimi i Besëlidhjes së Vjetër*. Në Betlehem këtë e rishikon sipas Hexaples së Origenit. Nga rishikimi i tij kanë mbetur

– *Liber questionum hebraicorum in Genesim* – Pyetjet hebraike mbi Zanafillën.

– *Liber interpretationis hebraicorum nominum* – Mbi etimologjinë e emrave hebraikë.

– *Comentarii in psalmos* – Komentet i shkurtër të Psalmeve.

– *Comentarius in Ecclesiastem* – Komentet i Librit të Kishtarit.

– *Comentarii in Isaiam* – Shpjegimet e Isaisë. Vlen të theksohet se ky koment i Jeronimit dallohet shumë nga të tjerët dhe është më i miri. Këtu Jeronimi ndërron stilin e përkthimit, kalon nga përkthimi alegorik në

b) *Adversus Helvidium de Mariae Virginitate perpetua* – Kundër Helvidit dhe në mbrojtjen e virgërisë së përhershme të Marisë. Helvidi thoshte se Maria ishte virgjër deri në lindje, por sipas traditës hebraike me Jozefin ka pasur edhe fëmijë tjerë. Këtu Jeronimi mbron pastërtinë dhe virgërinë e Marisë dhe të Jozefit.

Jeronimi ka edhe vepra tjera më pak të rëndësishme. Shkruan edhe mbi jetën e shenjtëve si p. sh. *Vita sancti Pauli*. *Vita sancti Hilarionis*, ndërsa ka edhe më tepër se 100 predikime.



# Familja dhe ndryshimet kulturore

*Veprimtaria e Ungjillëzimit, në të cilën jemi të thirrur të veprojmë pors besimtarë, nuk na përjashton nga konteksti kulturor, në të cilin njeriu jeton dhe në të cilin edhe besimi i vet shprehet. Kurora e Martesës dhe familja ndodhen në një proces të vështirë, në të cilin Kisha ka një kujdes vigjilent mbi ndryshimet aktuale të shoqërisë. Duhet një shikim për ta qartësuar idenë, për t'i parë me vëmendje ligjet dhe legjislacionet e vendeve të ndryshme, të cilat shpeshherë edhe diskutohen dhe debatohen, dhe në disa raste i kanë aprovuar. Kështu shihet se disa projekte të avancuara janë fryt i një lëvizjeje të dyfishtë me shumë keqkuptime dhe kontradikta të ndryshme.*

■ SHKRUAJ:  
Don Lekë Oroshi S.D.B.

**P**rojekti i Zotit mbi kurorën e martesës dhe mbi familjen e ka parasysh njeriun: burrin dhe gruan, më konkretisht, ekzistencën e tyre në situata të veçanta sociale dhe kulturore. Kisha, për të kryer veprimtarinë dhe shërbimin e saj, duhet aplikuar dhe duhet njohur situatat brenda saj ku kurora e martesës dhe e familjes sot realizohet. Kjo njohuri është, pra, një nevojë e pashmangshme e punës dhe e veprimtarisë ungjilëzuese. Kjo pra është shprehja e Papës Gjon Palit II në Familiaris consortio numër 4, ku e shfaq të vërtetën e vet dhe aktualitetin e thellë të realitetit të jetesës dhe sfidave.

Duke u bashkangjitur hyrjes së mësipërme, nga një anë po e shohim ndryshimin kulturor që nga disa dekada po ndodh, në mënyrë të veçantë në pjesën perëndimore të botës; në anën tjetër po shihet edhe vullneti për t'u imponuar një model i jetës që me vrull kërkon të mohojë identitetin e familjes, kështu siç është zhvilluar, duke u nisur nga koncepti i jetës së krishterë. Këto dy aspekte janë të ndërlidhura njëri me tjetrin dhe kërkon një analizë specifike, të aftë për ta identifikuar shkaku në këtyre ndryshimeve.

Prandaj, transformimet kulturore në këto momente janë frytë të një procesi të gjatë që e shohin "lindjen e një moderniteti" në "postmodernitet". E para, shkon kah përfundimi i saj duke marrë me vete vëndimet e mëdha, të cilat kanë krijuar progres, së bashku edhe me kontradiktat që kanë shënuar edhe fundin e saj; kurse e dyta, tregohet edhe e dobët, e ngarkuar me peshë në shpatulla dhe e pasigurt, e vendosur në këtë rrugë.

Në këtë tension, nga progresi i arritur drejt një pasigurie në të ardhmen, hyn edhe identiteti i familjes. E futur në mënyrë radikale në problematikën shoqërore, në të cilën e formon qenien themelore dhe bazike, ajo përjeton pra, transformimet kulturore, ku shenjat janë të ndeshura në relacionet mes gjeneratave të komponentëve të gjirit familjar. Është kjo një formë bukur e përzier dhe e shpërndarë, ku tenton të krijojë një lloj konflikti mes sugjerimeve fetare dhe parashikimeve për progres. Është mirë të qartësohet që nga fillimi që një ndryshim kulturor, për të qenë efikas, nuk merr por si model formime të ndryshme

ideologjike, të cilat i kundërvihen besimit. Në qoftë se është kështu, do të ndodhte fundi total i progresit kulturor siç ka qenë i menduar nga fillimi.

Çdo kulturë, prandaj, kur nënkuptohet në mënyrë të determinuar pors i tillë, do definuar në mënyrë dinamike, të hapur, për të evoluuar modelin që e bart në vete, e assesi për ta shkatërruar atë. Ekziston brenda kulturave një formë natyrore e rezistencës për t'i mbrojtur vlerat e veta, që e kanë lejuar të arrihet një identitet personal i popullit dhe civilizimit. Të shprehemi me mendimin e Saussure, ekziston një "shtytje kolektive" – një "elan vital", që kundërshton ndaj modifikimeve të raporteve mes shenjës e që është krijuar dhe kuptimit të saj origjinal, që e ka prurë deri të ekzistencës. Një kulturë, pra, nuk e tenton vetëvrasjen, por synon një gjeneratë – një ngjizje.

E njëjta gjë mund të vërtetohet edhe ndaj progresit; ai është i tillë në atë përmasë që është i

progresit, e, për paradoks, kërkonet mbrojtja dhe ruajtja.

Formulimi i Jacques Maritain, një nga etërit i "Kartës për të drejtat themelore të njeriut", është formulim ndriçues. Kulturën ai e definon si një hapje të jetës konkrete njerëzore, e cila lejon të jetohet një ekzistencë e konformuar në mënyrë etike ndaj ligjeve të natyrës dhe që është në gjendje të lejojë një zhvillim real të kapaciteteve të ndryshme dhe të pranishme në njeriun. Koncili i II i Vatikanit e jep këtë perspektivë, mbasi e ka identifikuar pors traktatet themelore të kulturës procesin e humanitetit të të gjithë jetës personale dhe sociale, për të lejuar një progres dhe përparim autentik, i parë në ruajtjen e gjendjes së arritur të të gjithë qenies njerëzore. Një tekst i *Gaudium et spes* e shpreh në mënyrë të qartë dhe të bindur: "është vetë e personi që nuk mund të arrijë një nivel të jetës me të vërtetë dhe të plotë human përmes nëpërmjet kulturës, duke kultivuar

nyrë që pors bazë është një mendim relativ dhe kontradiktore i natyrës, i jetës dhe i personit dhe kështu jepet një vizion shkatërrues i identitetit personal dhe shoqërorë. Mos aftësimi, pra, të prezantohet një e vërtetë e cila është universale e ndalon të propozohet një model determinues për progres – zhvillim të mbarë njerëzimit. Prandaj, nuk mund të zhvillojmë tani, një analizë të përfilltë të fenomenit të tillë.

Një lexim i kujdesshëm dhe përgjegjës i fakteve, i studiuar në shumë vende dhe mënyra, na ndriçon disa shkaqe të cilat na bëjnë dhe krijojnë aq shumë komplekse debatet aktuale rreth këtyre temave: e para mbi të gjitha një koncept të gabuar mes raportit të njeriut me natyrën dhe kështu edhe në ndryshimet të raporteve inter – personale. Pra, kërkimi dominant i njeriut mbi natyrën, pa i respektuar ligjet ekzistuese në proceset natyrore, e ka pruar në një modifikim të sjelljeve të cilat efekte, mbi të gjitha në fushën e ekzperimenteve, janë të verifikuara menjëherë.

Papa Gjon Palit II në mënyrë të kjashtë e ka shprehur këto kontradikta kur e ka shkruar *Evangelium Vitae*: "nga kjo, njëherë i përjashtuar nga pikëqëndrimi në Zotin, nuk duhet besasur që kuptimi i të gjitha gjërave del thelbësisht i deformuar dhe e njëjta natyrë, jo më, "nënë", të jetë e mbetur në "materiale" e hapur mbi të gjitha manipulime" (nr. 22).

Nuk mund të nënvlerësohen efektet e provokuara nga një keqkuptim nga lëvizja e lirisht të gruas. Ajo e ka determinuar, në shumë raste, një modifikim radikal të roleve në raporte interpersonale dhe kështu e ka bërë të zberthejë ekuilibrin e identitetit të subjekteve. Gruaja e ka forcuar drejtësisht personalitetin e saj, duke e ligështuar në mënyrë dramatike burrin i cili duket i mbyllur në një cilindër adoleshencial nga e cila shumë me vështirësi mund të dalë.

Nuk mund të mos reagojë as nga shkaku i ardhur nga ekonomia e tregut. Duke shfrytëzuar një mirëqenie e rritur, është dal ngadalë imponuar një stil i jetës i cili bënë nga trupi një objekt unik i tërheqjes.

Mjafton të mendohet pra,

fitness-i, ose konsumimi i prodhimeve kozmetike në gjerësi, ku shifrat e tyre mund të balancojnë bilanci e të gjitha nacio-naliteteve. Kjo gjendje e gjërave bënë të qartësohen gjithmonë e më tepër, sensin e lartë të narcizmit, që i përmbledhë gjeneratat e ndryshme.

Si përfundim dhe sintezizim, i shpjegimit të shpejtë dhe të thjeshtë, na nevojitet vetëm për të nënvizuar se shumë ndryshime nuk janë asgjë përpos disa forma të kushteve ideologjike dhe si të tilla nuk mund të jenë të konsideruara thjesht vetëm "kulturore". Ato tentojnë të krijojnë situata të shtritura, të cilat ndryshojnë me kalim të shpejtë të gjeneratave. Kjo spjegon pra, edhe kalimin e saj të shpejtë të shuarjes; së shpejti do të shtohen edhe shprehjet, modat ose tendencat gjithashtu të kaluara; duke krijuar prapë rrethana të dobësimit, vonesa të proceseve në rritje dhe në pjeke.

Nënkuptohet prandaj, të ecët në një rrugë në të cilën duhet jepen forcm për një vlerësim të tensioneve e edhe aspektet pozitive të ndryshimeve kulturore ne akt.

Vetëm kështu mund të vlerësojmë dhe të verifikojmë në mënyrë që të shtyrat energjike të pranishme në të mund të lejojnë të gjejmë forma të cilat, pa e ngacmuar familjen, mund të promovojnë zhvillimin e saj të frytshëm.

Me një fjalë, nuk besojmë se kur flitet për familje duhet shtohet parafolja "tradicionale", pors gjithmonë ndihet në fjalët tona.

Familja kualifikohet kështu, pors, siç e simploter (thjesht dhe kështu).

Pra në këto kushte të zhvillimit e jo të zëvendësimit mund të parashikohet një progres – zhvillim kulturor të cilën mund ta përfshimë edhe shoqërinë dhe kulturën.

Sigurisht shtjellimi i kësaj teme mund të jetë i mangështëm, por kjo ide e analizës na ndihmon të jemi optimist dhe të kemi vizion të qartë dhe largpamës mbi familjen, e cila e krijon kulturën dhe kultura duhet bazuar në familje.

E tërë kjo, nuk është e lehtë por nuk është e pamundur.

Prandaj, së bashku mund të punojmë në të gjitha fushat, në ato shoqërore dhe personale, në ato politike dhe akademike, në ato arsimore dhe fetare të krishtera.

Në bashkëveprimtari, sigurisht do të verifikohet rezultati shumë pozitiv dhe afatgjatë.



afër për t'i tejkaluar kontradiktat e krijuara nga dinamika që buron nga origjina dhe i jep shtytje për krijimtari. Për t'i shprehur më mirë idetë, mund të bëjmë një pyetje: kur ka një progres të vërtetë brenda ndryshimeve kulturore ndaj institucionit familjar? Një mendim bazë ndaj shumë ligjeve e mban hapësirën e konceptit të saj, gjer në arsyetimin e formave ku edhe shpesh e mohojnë dhe krijojnë kontradikta. Kjo situatë vihet në anën e kundërt nga definicionet e kulturës dhe të progresit kulturor. Kontradiktat e definimit të konceptit të familjes, e shpiten atë konkretisht gjer të shkatërrimi i formës origjinale; dmth, pra, si rezultat ndodh çorientimi në vend të

të mirat dhe vlerat e natyrës. Për këtë, çdo herë që bebet fjalë për jetën humane – njerëzore, natyra dhe kultura janë si kurrë gjer më tani të ndërlidhura" (Gs 53). Këto konsiderime të thjeshta janë të domosdoshme për të mos i përzier planet e diskutimit: disa lëvizje kulturore të sotshme kërkojnë të shprehin opinionet e veta të duhura dhe pors ato që, në fakt, ecin duke kujtuar se familja është shkakartja e proceseve kulturore në akt. Prandaj shihen pasojat se kush nuk dëshiron të adaptohet me të, duhet identifikuar pors nisima e një lëvizjeje të një ruajtjeje e cila kundërvihet ligjeve të progresit dhe të civilizimit. Një analizë e përpiktë e këtyre mendimeve, jep evidencë, në më-

*Kuvendi i motrave karmelitane në Nënshat*

# “Zoti është aq i madh, sa që ia vlen t’ia dhurosh t

■ SHKRUAN:

Violeta MARASHI, Dioqeza e Sapës/ Shqipëri

Në Nënshat të Shkodrës, është ndërtuar një vatër lutjeje për Shqipërinë dhe shqiptarët. Aty gjenden Motrat Karmelitane, që ndryshe nga kongregatat e tjera, kanë një karizmë të veçantë. Thirrja e tyre është lutja, e lutja është jeta e Karmelitanëve. Bashkimi me Zotin në seditje dhe bashkimi vëllazëror në komunitet të vogla, janë qëllimi i jetës karmelitane. Ndërsa zemra e rregullit është “të sodisë natë e ditë ligjin e Zotit dhe të vigjilojë në lutje”.

## Urdhëri Karmelitan

Urdhëri i Karmelit ka origjinë shumë të lashtë. Në fund të shek. XII dhe në fillim të shek. XIII shitësit, klerikët... që dëshironin të jetonin një jetë në vetmi, tërhiqen në vetmi afër burimit të Elisë mbi malin e Karmelit (Palestinë). Mbi shembullin e Elisë profet, profeti i zjarrit, këto vetmitarë, jetojnë në praninë e Zotit, duke u ushqyer me Fjalën e Zotit dhe me Trupin e Tij, në vetmi të madhe dhe në shmanגיע totale nga bota. Pra, aty janë bashkuar murgjit në një kapelë, të cilën ia kanë kushtuar Virgjëres Mari. Për këtë edhe Rregulli quhet: “Rregulli i së Lumës Virgjër Mari të Malit Karmel”. Fjala “KARMEL” do të thotë **Kopsht i lulëzuar** dhe është mali në i bukur në Izrael si dhe vend i përshatshëm për lutje, meditim, seditje.

Karmeli është përhapur në Evropë në shekullin e XIII, kurse në shek. XVI, rregullin e reformuan në Spanjë, **Shën Tereza e Avilës** (1515-1582) dhe **Shën Gjoni i Kryqit** (1542-1591) shenjtër. Në botë sot numërojmë rreth 775 kuvende të Motrave Karmelitane dhe 556 kuvende të etërve karmelitanë. Rregulli është përhapur nga Spanja në Itali, Austri, Kroaci nga edhe erdhën në Shqipëri. Tereza e Jezusit dhe Gjoni i Kryqit, janë dy shtyllat që riformuan Karmelin.

**Tereza e Jezusit** në moshën 47 vjeçe, duke lënë Manastirin e Mishërimit në Avila, ku hyri në moshën 20 vjeçe e duke themeluar Karmelin e Shën Jozefit, gjithmonë në Avila, nga fillimi formon Karmelin (Karmelitanët e zbatuar). Dëshira e Terezinës është të kthehet tek burimi. “Të kujtojmë etërit e shenjtë të vetmuar, jetën e të cilëve pretendojmë ta imitojmë”.

**Shën Gjoni i Kryqit** është lindur më 24 qershor 1542 në Fontiveros - Kastila, në Spanjë, në një familje të varfër. Që në moshë të re u detyrua të punojë. Provoi disa zanate, por puna fizike nuk i shkonte fort mirë. Zoti nuk e kishte thirrë për punë të tillë. Më në fund gjeti punë si infermier në një spital, ku pati rast të praktikojë dashurinë e krishterë ndaj të sëmurëve, në të cilët shikonte vetë Krishtin e vuajtur.

Njëkohësisht edhe student, e jashtëzakonisht mirë përparonte në letërsi dhe në gjuhë latine. Kishte prirje kah meshtaria dhe përshtirëria seditëse. Si 20-vjeçar, hyri në kuvendin e Karmelitanëve. Si meshtar i ri, gati kishte vendosur të kalojë në rregullin e kartuzianëve, të cilët i kishin rregullat shumë më të rrepta sesa karmelitanët e tij. Por Zoti, pati me të një plan tjetër. Më 1567 Gjoni u takua me Shën Terezën e Avilës, e cila që më 1562 e kishte filluar reformën e motrave Karmelitane. Ai menjëherë e kuptoi shenjtërinë e saj, si edhe ajo përsosmërinë e tij. Ajo i propozoi që, edhe ai të vepronte në reformën e vëllazërve Karmelitanë. Ai me gatishmëri

e pranoi këtë ide. Shumë shpejt, pas vetëm një viti, më 28 nëntor 1568, u themelua bashkësia e parë e karmelitanëve të reformuar. Angazhimi i Shën Gjoniit ishte aq i madh dhe reformat e tij ishin aq të thella dhe të rrepta, sa që në fillim kishte edhe shumë kundërshtime të forta brenda bashkësisë së vet. Madje, 9 muaj i kaloi edhe në burgun e Kuvendit të Toledos, por nuk u dorëzua.

Më në fund, mundi iu kuro-rëzua me sukses: më 1850 Papa Gregori XIII, lejoi themelimin e një province të karmelitanëve të reformuar, kurse Klementi VIII, më 1593, e shpalli pavarësinë e plotë të të dy degëve të karmelitanëve. Të dy, si Shën Tereza e Avilës ashtu edhe Shën Gjoni i Kryqit sot nderohen si shenjtër dhe doktorë të Kishës.

## Themelimi i Karmelit – Nënshat

Pas viteve '90, në Shqipëri ndo-

dhën shumë ndryshime. Ndryshimi më i rëndësishëm ishte rikthimi i lirisë fetare. Një e drejtë e kjo e mohuar për shumë vite me radhë nga regjimi ateist. Menjëherë filluan të vinin misionarë nga Italia, Gjermania, Kosova etj., të cilët përmes shërbimit dhe punës së tyre e rimëkëmbën popullin shqiptar si në anën shpirtërore, ashtu edhe në atë ekonomike-social-kulturore. Ndër këto misionarë ishin edhe meshtarët kosovarë, tani ipeshkëvij, Mons. Dodë Gjergji dhe Mons. Lucjan Avgustini. Me ardhjen e tyre në vitin 1994, nisur edhe nga kontaktet që këta kishin me Motrat Karmelitane në Kroaci, lindi ideja që në Shqipëri do të ishte i domosdoshëm një kuvend murgeshash të Urdhërit Karmelitan. E kjo ide e dy misionarëve, pranohet me një gëzim të madh nga Arqipeshkëvi i Shkodrës (në atë kohë) Mons. Frano Ilia. Ide që u shua pas vdekjes së tij. Ndër-

sa me emërimin e Mons. Dodë Gjergjit si Administrator Apostolik në Dioqezën e Sapës, në vitin 2000, mundësia për të realizuar këtë dëshirë ishte edhe më e madhe. Falë iniciativës së tij dhe me aprovimin nga Selia e Shenjtë Apostolike në Romë, kjo ide tashmë ishte e gatshme për t’u vënë në jetë. Kështu, më 16 mars 2002, nga Arqipeshkëvi i Shkodrës Mons. Angelo Mas-safra, bekohet Gurë - Themeli i Parë – Karmel në Nënshat, në ish-Selinë e Dioqezës së Sapës.

Falë kontributit të dhënë nga bamirësit dhe donatorët, falë angazhimit dhe punës intensive të vetë Ipeshkëvit të vendit e bashkëpunëtorëve të tij, për një vit bëhet e mundur ndërtimi i Kuvendit. Në vitin e Shenjtë Jubilar të jashtëzakonshëm, 2003, dhe me rastin e 300-vjetorit të Kuvendit të Arbërit, Dioqeza e Sapës themelon Kuvendin e Parë Kontemplativ të Motrave Kar-





# tërë jetën”

(Shën Tereza e Avilës)



Mons. Dodë Gjergji dhe motrat karmelitane

melitane. Ishte dita e Shenjtërve Krye-Ëngjëj Mikeli, (Mëhilli), Gabrieli dhe Rafaeli, më 29 shtator 2003, që përkoi me Themelimin dhe Bekimin e Kuvendit të parë Kontemplativ të Motrave Karmelitane në Shqipëri. Ndërsa gjithë riti i bekimit u krye nga Përfaqësuesi i Selisë së Shenjtë në Shqipëri, Nunci Apostolik, Giovanni Bullaitis. Ngjitur me Manastirin është ndërtuar edhe Kisha, e cila i kushtohet Shën Mëhillit. Nisur nga kjo, Karmeli në Nënshat quhet i Familjes së Shenjtë dhe Shën Mëhillit.

## Jeta në bashkësi dhe puna aktuale e Motrave

Karmeli është i gërshtuar prej jetës në vetmi dhe në bashkësi. Ndërkohë që Jeta me Zotin vazhdon edhe në bashkimin motor. Dy orë në ditë Karmelitania i kushtohet lutjes së brendshme në heshtje, si dhe soditjes në vetminë e klauzurës. Më pas,



kultivon lutjet liturgjike, në veçanti Eukaristinë. Jeta e motrave kërkon ambient heshtjeje dhe tërheqjeje. Këtë ua mundëson vetëm klauzura, vendi ku ato ndjehen vërtetë të lumtura.

Motrat e filluan jetën në Nënshat më 21 maj 2003. Në fillim erdhën 7 motra: tri nga Kroacia dhe katër nga Kosova e Mali i Zi. Ndërsa sot Zoti e ka pasuruar këtë manastir me thirrje të reja. Aktualisht, gjenden 12 motra Karmelitane, ku 4 prej tyre janë kandidatë – vajza shqiptare nga Shqipëria, të cilat e kanë ndierë thirrjen e Zotit dhe duan t'i kushtohen atij me gjithë qënien e tyre. Misioni i motrave është të luten me devotshmëri për paqen, harmoninë dhe mirësinë e të gjithëve. Arsyeja pse gjenden në Shqipëri, në këto vende, është që, nëpërmjet lutjeve e sakrificave të bëjnë të pranishëm besimin në Jezusin dhe nevojat shpirtërore të këtij populli të vuajtur, duke ia paraqitur Hyjit të gjithpushtetshëm, ku merren hirit dhe bekimet e Tij. Siç shprehen edhe vetë motrat, lutja jonë është për mbarë Kishën, në mënyrë të posaçme për meshtarët dhe të gjithë besimtarët. Sidomos e kujtojmë popullin tonë shqiptar kudo ai qoftë, që të jetojë i lirë në çdo aspekt të jetës dhe me dinjitet.

Përveç lutjes, motrat kanë edhe momentet e "rekreacionit", d.m.th. "të jetuarit së bashku". Kjo është kohë kur ato lirisht mund të bisedojnë, të luajnë dhe të shkëmbejnë përvojat shpirtërore. Po ashtu, motrat, në oborrin e Manastirit kanë ngritur edhe kopshtin, në të cilin ato punojnë. Nisur edhe nga fjala Karmel, që do të thotë kopësht i lulëzuar, në të vërtetë edhe ky kopësht është i lulëzuar. Ato përmes punës së duarve të tyre, mbjellin çdo fryt sipas stinëve që i përshkruan. E po me këtë prodhim që marrin nga kopshti edhe jetojnë. Por sigurisht që, nuk mungon edhe financimi i kongregatës qendrore të karmelitanëve.

Gjithashtu, një pjesë të mirë të kohës gjatë ditës motrat duhet t'ua kushtojnë edhe njerëzve. Presin shumë vizitorë-besimtarë, grupe të ndryshme, jo vetëm nga zona përreth, por nga e gjithë Shqipëria. Këto njerëz, për nevojat e tyre shpirtërore, ngjiten shpeshherë edhe me këmbë në Karmelin e Nënshatit, që shtrihet në malin e Shën Mëhillit, larg shtëpijave ku banojnë nënshatasit. Bashkë me motrat ato luten, bashkëndajnë problemet dhe hallet që secili i ka, ngushëllojnë shpirtat dhe marrin me vete paqë e dashuri. Ndërsa motrat iu premtojnë lutjet për nevojat e tyre.

Çdo takim, qoftë në Kishë, qoftë në dhomën e pritjes, bëhet përmes perdevës të hekurta. Shumë persona, duke mos njohur rregullat e klauzurës, kur vijnë për herë të parë, mbesin disi të habitur. Aq më tepër kur shohin në sytë e motrave gjithë atë gëzim, alegrë e buzëqeshje të pafund për jetën që vetë Krishti ua ka dhuruar. E madje shumë pyetje iu vijnë në mendje: Përse hekurat? Çfarë shërben një murgeshë e klauzurës? Në këtë kohë?

"Thirrja e karmelitanëve zbatuar, është një dhuratë e shpirtit për të cilin janë thirrur në një bashkim të mistershëm me Zotin në shoqërinë e Krishtit dhe në intimitetin me Zojën e Bekuar, në një ekzistencë në të cilin lutja dhe flirimi i bashkohen Kishës me një dashuri të madhe". (Costituzioni, 10).

"Thirrja e misioni i motrave të klauzurës është "shenjë e bashkimit ekskluziv me Kishën-Nuse me Hyjin e saj, tejet i dashur". (Verbi Sponsa, 59).

Përveç shpjegimit nëpërmjet kushtetutës që theksojmë më lart, edhe vetë motrat Miriam, Marija, Zoja, Bardha, Marjana dhe Roza shprehen: fizikisht nuk jemi me besimtarët, por me to i bartin gjitha vuajtjet si dhe gëzimet, sepse jemi në trupin

mistik të Krishtit, jemi gjymtyrët e Tij. Kërkojmë të jemi më pranë besimtarëve "shpirtërisht", me anë të dashurisë, paqes dhe lutjeve që do i kërkojmë Zotit për të gjithë shqiptarët, e në veçanti për diqqezën e Sapës. Për ta jetuar këtë thirrje është e domosdoshme atmosfera e heshtjes, e vetmisë, e tërheqjes. Jemi të bindura se ia vlen për Zotin, ashtu thotë edhe nëna jonë Tereza e Avilës: **"Zoti është aq i madh, sa që ia vlen t'ia dburosh tërë jetën!"**

## Varret

Pak metra nga Kuvendi ku je-

tojnë, në kopshtin e Manastirit, motrat kanë ndërtuar edhe varret e tyre. Secila i sheh çdo ditë mu para syve. Është ky vendi i premtuar, kur në momentin që do largohen nga jeta në tokë, trupi i tyre do të rehatohet, ndërsa shpirti do të ngritet në qiell pranë Zotit, në Mbretërinë e amshuar. Po të pyesësh motrat, se a ju bën përshtypje që varret t'i kenë ndër sy çdo ditë? Me gëzimin më të madh – ato përgjigjen: Ne ia kemi dhuruar jetën tonë Krishtit. Jemi nusët e tij. E mezi presim që ta takojmë e të bashkohemi me të në përjetësi.

## Disa mendime shpirtërore të Shenjtërve të Karmelit

"Mendo gjithmonë se çdo gjë në të kaluarën tënde: edhe lumturia, edhe disfata vijnë prej Zotit, që për shkak të së parës të mos lartësohesh, as për shkak të së dytës të mos dëshpërohesh".

*Sb. Gjoni i Kryqit*

"Vullnesën e Zotit e bëjnë vetëm dy gjëra: dashuria ndaj Zotit dhe dashuria ndaj të afërmit".

*Sb. Tereza e Avilës*

"Kush e don personin e dashur, e sheh ashtu siç e ka krijuar dora e Hyjit".

*Sb. Edith Stein*

"Të jetosh prej dashurisë, do të thotë të dhurohesh pa kufi".

*Sb. Tereza e Vogël*

"Kudo që të jesh, Zotin e ke në vete".

*E Lumja Elizabetë e Trinisë së Shenjtë*

"Gjithmonë ki parasysh se nuk erdhe për tjetër gjë, përveç se të bëhesh i shenjtë. Prandaj lejo që në shpirtin tënd të mbizotërojë vetëm ajo që drejton kah shenjtëria".

*Sb. Gjoni i Kryqit*

"Zoti na don më tepër se sa ne e duam vetveten".

*Sb. Tereza e Avilës*

"Në kuvend nuk vihet që të ikësh prej botës, por që botën t'ia paraqesim Zotit".

*Sb. Edith Stein*

"Dashuria do t'iu japë flatëra".

*Sb. Tereza e Vogël*

"Dashuri! Në këtë fjalë është e përfshirë e gjithë shenjtëria".

*E Lumja Elizabetë e Trinisë së Shenjtë*



Intervista me myfti Rexhep Bojën

## Kisha Katolike dhe Bashkësia Islame e Kosovës - të bashkuara në gëzimet dhe hidhërimet e fatit të popullit tonë

*“Çdo ekstremist është i rrezikshëm kur imponohet. Këtu nuk luan rol të madh emri, edhe ky emër që i quajmë vehabi. Ka prej tyre të mirë, por ka prej tyre që nuk janë në nivel të njohurive dhe në mungesë të njohurisë së pastër islame, përdoron forcën që ndaj të tjerëve t'i imponojë mendimet e tij.”*

**Për një kohë të gjatë keni drejtuar Bashkësinë islame të Kosovës, raportet e kësaj bashkësie me komunitet tjerë fetare në Kosovë ishin më të ngrohta dikur...?**

Po, për një kohë të gjatë isha në krye të BIK-ut, një periudhë 13 vjeçare 1990-2003 dhe raportet me komunitetin katolik ishin të ngrohta dhe vëllazërore, kishim një bashkëpunim për interes të popullit tonë, në pajtimin e gjacëve etj. Pra, në ndihmë popullit që do të thotë ku ishte populli ishim edhe ne. Kurse me komunitetin ortodoks nuk kishte marrëdhënie. Pozicionimi i tyre përkrah agresorit serb ka bërë që të mos ketë marrëdhënie. Vetë peshkopi i tyre Artemije, ishte përkrah ushtrisë, policisë e paramilitarëve serbë që dhunuan e masakruan popullin tonë, e në asnjë mënyrë nuk u distancuan nga veprimet e tyre.

**Ju njiheni si një linjë e butë, më e moderuar e islamit, a ndahet islami në disa linja apo është një tërësi?**

Islami ka një tërësi dhe burim kryesor i kësaj është Kur'ani si dhe tradita e mirë që janë bazë në islam. Unë, për fat, kam studiuar islamin dhe traditën shqiptare dhe duke vepruar në bazë të edukatës islame dhe traditës shqiptare është shkak që qëndrimet e mia të duken më të buta, kurse tjerëve, që u mungojnë njohuritë ndaj islamit dhe traditës shqiptare, në vepra dhe në qëndrime të tyre, duken më ekstremë.

**Për juve shkruhet se nuk keni treguar mikpritje për vehabistët e ndryshëm në Kosovë? Kush janë vehabistët, a e rrezikojnë ata islamin apo janë rrezik për të tjerët?**

Është e vërtetë se unë nuk e kam pritur mirë traditën që nuk

përshtatet me traditën vendore. Sjelljen e tyre ndaj shoqërisë, dukjen dhe veshjen e tyre. Mos-pajtimi im ka të bëjë edhe ndaj atyre që vijnë nga jashtë me synime të një drejtimi të veçantë, si një formë imponimi në gjëra që çojnë në ekstremizëm, që rrezikojnë islamin dhe shoqërinë, shkaktojnë përçarje në mesin e besimtarëve. Kam shprehur pakënaqësi edhe ndaj atyre përfituesve të donacioneve “humanitare” që e shmang drejtimin e tyre humanitar.

**Vehabistët janë prezentë në Kosovë, çfarë të mirë ka Kosova dhe shoqëria jonë prej tyre?**

Çdo ekstremist është i rrezikshëm kur imponohet. Këtu nuk luan rol të madh emri, edhe ky emër që i quajmë vehabi. Ka prej tyre të mirë, por ka prej tyre që nuk janë në nivel të njohurive dhe në mungesë të njohurisë së pastër islame, përdoron forcën që ndaj të tjerëve t'i imponojë mendimet e tij.

Në Kosovën e pas luftës ka gjithçka, por besoj që populli ynë është i vetëdijësuar, pasi ka filluar të dalë nga kriza e shumëfishtë dhe ta pranojë atë që është pozitive dhe e dobishme.

**Shpeshherë jeni shoqëruar me të ndjerin imzot Mark Sopin. Cilat ishin raportet Tuaja me atë?**

Kam pasur nderin të shoqërohem me atë burrë të madh, ipeshkëv Mark Sopin. Ishim shokë në gëzimet e hidhërimet e popullit tonë. Ishte njëri i madh, kishte një respekt të madh ndaj meje e që edhe unë jam munduar t'ia kthej respektin e merituar. I kishim parimet tona fetare, por asnjëherë nuk kemi pasur asnjë keqkuptim, as më të voglin. E kishim ndihmën e njëri-tjetrit

kur udhëtonim nëpër Perëndim dhe në Lindje. Kishim një bisedë të singertë dhe gazmore e që të tjerët na kishin lakmi kur na shikonin bashkë.

Urimet tona të ndërsjella për festa ishin me kënaqësi, sepse në to ishin urimet tona më të singerta. Por vdekja prish punë shumë.

**Ju keni lobuar në vendet islamike arabe për pavarësinë e Kosovës, pse ata nuk e pranojnë Kosovën?**

Po, e vërtetë është se kemi marrëdhënie të mira me botën arabe dhe atë islame. Kam kryer studimet atje, gjë që ka bërë që unë të njihem me shumë njerëz dhe personalitete të asaj bote. Shokë të studimeve, me të cilët kam qenë, një pjesë e tyre tani janë nëpër po-

zita të larta, nëpër vende të ndryshme të botës arabe. Lidhja ime është shtuar në kohën kur isha në krye të BIK, e që për më tepër jam anëtar i përhershëm i Ligës Botërore Islame, ndërsa afërsia ime me familjen Zayed Al-Nahyan e cila udhëheqë Emiratin e Bashkuara Arabe, dhe e cila ka ndikim të madh tek shumë udhëheqës të shteteve arabe, raportet e mia miqësore me sekretarin e përgjithshëm të konferencës Islamike Dr. Ekmeleddin Ihsanoglu, më ka dhënë mundësinë që t'i shfrytëzoj këto lidhje ku kam arritur që të lloboj për pavarësinë e Kosovës, e që si rezultat erdhi deri të njohja e Kosovës shteti pavarur nga Emiratet e Bashkuara Arabe. Mirëpo njohja e Kosovës nga ajo pjesë e botës nuk ka të bëjë me çështje fetare, është çështje

kryekëput politike. E kjo gjë po dëshmohej, po të ishte çështje e institucioneve fetare BIK ka bërë shumë për njohjen e Kosovës, po ashtu edhe Ipeshkvia ka bërë në atë të sajën për njohjen e Kosovës nga Vatikani.

**Myslimani i mirë si duhet t'i trajtoj ata që s'janë mysli-manë?**

Myslimani i mirë duhet t'i trajtoj të tjerët ashtu siç e udhëzon islami, dhe këto gjëra janë të precizuara shumë mirë nga urdhrat e Zotit. Nuk do të ishin këto konflikte e përçarje që ndodhin e që janë të shumta në botë, por do të përmbaheshim dhe përcaktoheshim të gjithë si besimtarë të mirë të Zotit.

(Intervistoi:  
Pjetër Ndue KAJTAZI, OFM)





# Deklarata e përbashkët e katolikëve dhe myslimanëve

Është e rëndësishme dhe impënjuese deklarata përfundimtare, e publikuar nga Vatikani dhe nga një përfaqësim i 138 pjesëtarëve të bashkësive islamike që e kanë nënshkruar këtë dokument. Në të dëshmohej, mes tjerash, respekti për jetën dhe për dinjitetin e çdo personi njerëzor, burrit e gruas, që sjell, mes tjerash, respektin e lirisë dhe fesë; refuzimin e diskriminimit për shkak të fesë; të dëshmohej vlera e lutjes dhe dimensionit transcendent të jetës në një botë të shekullarizuar; pohimin e detyrës së edukimit të të rinjve me një edukatë të shëndoshë morale, civile e fetare dhe t'i informojë mbi fenë e të tjerëve. Deklarata, ndërtë t'jera, flet mbi mundësinë e krijimit të një grupi të përzier dhe të përhershëm që ka për detyrë të shpallë një Forum të dytë për ta mbajtur, brenda dy viteve, në një vend me shumicë myslimane.

Forumi katolik-mysliman është krijuar nga dikasteri i kishillit Papnor për Dialogun ndërfeetar dhe nga një Delegacion i 138 pjesëtarëve myslimanë.

Seminari i parë u zhvillua në Romë nga 4-6 nëntor 2008. Kanë intervenuar 24 pjesëmarrës dhe pesë kishilltarë nga të dy religjionet. Tema e seminarit ka qenë: "Dashuria ndaj Zotit, dashuria ndaj të afërmit". Debat, i zhvilluar me një shpirt mirëkuptimi e dashamirësie, është koncentruar mbi dy tema: "themelet teologjike e shpirtërore", "dinjiteti njerëzor dhe respekti reciprok".

Kanë dalë pika të përbashkëta dhe të ndryshme që reflektojnë dy religjionet:

1. Për të krishterët burimi dhe shembulli i dashurisë ndaj Zotit dhe ndaj të afërmit është dashuria e Krishtit për Atin, për njerëzimin e për çdo person. "Hyji është dashuri" (1 Gjn 4,16) e "Vërtet, Hyji aq fort e dëshir botën sa që e dha vetë vetmin Birin e vet, kështu që, se-

cili që beson në të, të mos birret, por të ketë jetën e pasosur". (Gjn 3,16). Dashuria e Hyjit është e vendosur në zemrën e çdo njeriu nga Shpirti i Shenjtë. Është Hyji që se pari na ka dashur duke na lejuar në këtë mënyrë ta dëshmojmë edhe ne dashurinë për Të. Dashuria nuk e dëmtton të afërmin, por mbi të gjitha kërkon t'i bëjë tjetrit atë që dëshirojmë t'na bëjnë ne (Kor 13, 4-17). Dashuria është baza dhe përmbledhja e të gjitha urdhërimeve (Gal 5,14). Dashuria ndaj të afërmit nuk mund të jetë e ndarë nga dashuria e Hyjit, sepse është një shprehje e dashurisë sonë ndaj Hyjit. "Ky është urdhërimi: dua jeni njëri-tjetrin sikurse unë ju desha ju". (Gjn 13,12). I themeluar në dashurinë e sakrificës së Krishtit, dashuria e krishterë falë dhe nuk e përjashton askënd. Pra i përfshin edhe armiqtë e vet.

Nuk duhet të jenë vetëm fjalë, por fakte. "Frikë në dashuri nuk ka, sepse dashuria e përsosur e përjashton frikën, sepse frika nënkupton ndëshkimin. Pra, ai që trembet, nuk është i përsosur në dashuri". (Gjn 4,18). Kjo është shenja e të se vërtetës.

Për myslimanët, ashtu siç është paraqitur në letërratë quajtur "Një Fjalë e Përbashkët", dashuria është një forcë transcendent e paprishme, që udhëheq, e transformon respektin reciprok njerëzor. Kjo dashuri, ashtu siç është e paraqitur nga profeti Muhamed, i paraprin dashurisë njerëzore për Një e të Vetmin Zot.

Një hadit paraqet që dhembshuria e mëshira e Zotit për njerëzimin është me e madhe se ajo e një nëne për fëmijën e vet (Muslim, Bab al-Tawba: 21). Kjo dashuri e kjo mëshirë janë kështu të mëdha, që Zoti ka intervenuar për të drejtuar e shpëtuar njerëzimin në mënyrë të përsosur, në shumë vende e shumë herë, duke dërguar profetë e shkrime. I fundit është libri i Kuranit, paraqet shenjat e

një kozmosi të mrekullueshëm hyjnor, që ngjall dashurinë tonë dhe devocionin absolut derisa: "ata që besojnë e kanë për Allah një dashuri më të madhe" (2: 165) e "në të vërtetë i Mëshirshmi dhuron dashurinë atyre që besojnë dhe bëjnë të mirën" (19: 96). Në një hadit lexojmë që "Askush nga ju nuk ka fe deri sa nuk e duan të afërmin sikur vetveten" (Bukhari, Bab al-Iman: 13).

2. Jeta njerëzore është një dhuratë e çmueshme e Zotit për çdo person, duhet pra të ruhet dhe të respektohet në të gjitha fazat e saj.

3. Dinjiteti njerëzor vjen nga fakti se çdo person është i krijuar prej Zotit dashuri, i janë dhuruar arsyeja dhe liria, pra është i lejuar të duanë Zotin dhe të tjerët. Mbi bazën e qëndrueshme të këtyre parimeve, personit i takon respekti dhe dinjiteti i tij original i thirrjes së tij njerëzore. Pra e ka të drejtë me njohje të plotë të identitetit të vet dhe vetë lirisë së individit, bashkësi dhe udhëheqja, me përkrahjen e legjislacionit civil të garantojë të drejtë të barabarta dhe shtetësi të plotë.

4. Pohojmë se krijimi i njerëzimit nga ana e Zotit paraqet dy aspekte të mëdha: personi njerëzor mashkull e femër që së bashku të angazhohen dhe të garantojnë që dinjiteti dhe respekti njerëzor të shtrihen si meshkujve ashtu edhe femrave me të njëjtën barazi.

5. Dashuria e vërtetë e të afërmit kërkon respektin e personit dhe zgjidhjeve të tij në çështje të qëllimeve fetare. Ajo e ka edhe të drejtën e individit e të bashkësisë të praktikojë religjionin e vet në mënyrë private e publike.

6. Pakicat fetare kanë të drejtë të respektohen në bindjet dhe në praktikimin e fesë. E kanë edhe të drejtën që vendet e tyre për

kultet dhe figurat e tyre, simbollet themeluese që konsiderohen të shenjta, nuk duhet të pësojnë asnjë formë talljesh.

7. Besimtarët katolikë e myslimanë të jenë të vetëdijshëm në dëshminë e dimensionit transcendent të jetës nëpërmjet një përshtirërie të ushqyer nga lutja, e cila është duke u bërë gjithnjë e më shumë e shekullarizuar dhe e materializuar.

8. Dëshmojmë që asnjë religjion dhe as ndjekësit e tyre nuk duhet të jenë të përjashtuar nga shoqëria. Çdo njeri duhet të japë kontributin e domosdoshëm për të mirën e shoqërisë, në veçanti në shërbim të nevojtarëve.

9. Njohim që krijimi i Zotit në shumëllojshmërinë e kulturave, civilizimeve, gjuhëve e popujve është një burim pasurie, e pra, nuk duhet kurrë të bëhet shkak i të tensioneve dhe i konflikteve.

10. Jemi të bindur nga fakti që katolikët e myslimanët e kanë të drejtën t'u ofrojnë besimtarëve të tyre një edukim të shëndoshë në vlerat morale, religjioze, civile e njerëzore e të promovojnë një formim të kujdesshëm mbi religjionin e të tjerëve.

11. Dëshmojmë që katolikët e myslimanët janë të thirrur të jenë mjet i dashurisë dhe harmonisë mes besimtarëve e për tërë njerëzimin, duke mohuar çdo shtypje, dhunë, agresivitet e akte terroriste, në veçanti ato të bëra në emër të religjionit, e të mbahet parimi i drejtësisë për të gjithë.

12. Bëjmë thirrje besimtarëve të punojnë për një sistem financiar etik në të cilin mekanizmat normative e marrin në konsideratë situatën e të varfërve e të të braktisurve, qofshin ata njerëzit

apo kombet borxhlinj. Thërrasim të privilegjuarit e botës që ta marrin në konsideratë plagën e sa janë të prekur nga krizat aktuale në prodhimin dhe në ndarjen e gjërave ushqimore, u kërkojmë besimtarëve të të gjitha religjioneve e të gjithë njerëzve vullnet të mirë të bashkëpunojnë për të zbutur vuajtjet e atyre që kanë uri e të eliminohen shkaqet e kësaj të fundit.

13. Të rinjtë janë ardhmëria e bashkësive religjioze dhe shoqërisë në përgjithësi. Jetojnë në shoqëri multikulturore e multireligjioze. Është thelbësore të jenë të informuar mirë në traditat e tyre fetare e të informohen sidomos në tolerancë dhe në kulturat e tjera religjioze.

14. Kemi konkorduar të merret në konsideratë mundësia që të krijohet një grup katolik-mysliman i përhershëm, që të koordinojë dhe t'u përgjigjet konflikteve dhe situatave tjera emergjente, e të organizojnë një seminar të dytë në një vend me shumicë myslimane, por duhet ende kohë për ta definuar.

15. Presim pra seminarin e dytë të Forumit katolik-mysliman që do të zhvillohet në një vend me shumicë myslimane, ende të pacaktuar.

Të gjithë pjesëmarrësit ishin të kënaqur dhe të falënderueshëm për këtë dhuratë të Zotit dhe për kohën e kaluar së bashku me ballafaqime reciproke. Në fund të seminarit, Ati i Shenjtë Benedikti XVI, pas intervenimit të profesor Seyyed Hossein Nasr e të Myftiut Mustafa Qeriq, u është drejtuar me një fjalim këting Forumi. Të gjithë të pranishmit kanë shprehur kënaqësinë për rezultatat e arritura në seminar dhe pritjen e një dialogu më të thellë.



# Arbërit ndërmjet Lindjes dhe Perëndimit

■ SHKRUAN:  
Prof. dr. Jahja DRANÇOLLI

Tashmë është e njohur dhe në qarqe shkencore e përfillur teza se populli shqiptar është autokton dhe njëri ndër më të vjetrit në Evropë. Ky etnos, ndër shekuj, bashkë me etnoset e tjera autoktone të Ballkanit, u gjend shumë shpesh përballë stuhive që vinin nga anë të ndryshme. Në këtë kontekst, ilirët e antikitetit e arbërit e mesjetës u gjendën edhe përballë qytetërimeve të Perëndimit dhe të Lindjes, të ndarë sipas vijës së Teodosit (Teodosi, perandori romak, i cili ndau në vitin 395 Perandorinë Romake në Perandori Perëndimore dhe Perandori Lindore. Në histori kjo ndarje zuri të quhet vija e Teodosit – J.D.). Së këtejmi, edhe pse ilirët u sunduan me shekuj nga Perandoria Romake, një pjesë e

paravjetër, i armatosur me hobe, me një shkop të trashë dhe me një shigjetë të helmosur, shtymun prej instiktit për mbrojtjen e vendit: me ahmarje, me besë e tue bam lidhje gjaku. Ai për-lau katundet e buta ndër fusha, e me to për-lau edhe organizimet juridike [...]. Kështu për të tretën herë, mbas zhupanëve sllavë të mëparshëm, mbulohet Shqipëria [...] me formime fisesh të fuqishme, që qëndrojnë edhe sot”.

## Kryqtarët dhe tregtarët

Ajo që prezantohet si formë ndikimi që vinte nga Perëndimi gjatë periudhës që kemi në shqyrtim, nuk mund të konsiderohet si tërësi në vete. Njerëzit e Perëndimit erdhën në trojet tona etnike gjatë antikitetit përmes keltëve, galëve, romakëve, gotëve, longobardëve, etj. Ndërkaq, gjatë katër kryqëzave të para sidomos pas kryqëzatat së katërt (1202-1204), mbi

genësore rreth mundësive dhe forcave të ndikimit të tyre në hapsirën mesjetare arbënore. Perandoria Bizantine, në një anë që e afërt dhe fuqi e vjetër me rrënjë të thella, vijuese dhe mbrojtëse e traditës antike, me pretendime se me frymën e idealeve të veta politike t'i transformojë popujt, të cilët kolonizuan trojet e provincave të dikurshme romake. Në anën tjetër, pjestarët e Perëndimit dhe misionarët e tyre të ardhur nga viset e largëta (mes tjerash edhe për qëllime të përhapjes së qytetërimit të Perëndimit), të cilët kishin përberje etnike-sociale heterogjene, pasi që i takonin qarqeve të ndryshme të shoqërisë evropiane, mundësitë dhe aftësitë e tyre qenë të kufizuara dhe të orientuara vetëm në disa qarqe dhe lëmenjë të caktuar të jetës.

Pjestarët dhe misionarët e Perëndimit ishin të lidhur mes vete, vetëm në aspektin kishtarë-

Arbëri. Si rrjedhojë e këtyre antagonizmeve caktohet edhe kufiri kishtarë me kontura të qarta, por ende definitivisht të papërfunduara. Kufijtë e Argjipeshkëvisë së Ohrit, që u formuan menjëherë pas ngadhënjimit të madh të Bizantit në vitin 1018, shtriheshin në veri prej Danubit dhe Savës, duke u lëshuar në jug përmes vijës Sirmiun-Ras-Prizren-Durrës. Kufijtë e sipërm ishin njëkohsisht edhe kufijtë e Bizantit ortodoks në drejtim të Perëndimit dhe Veriut, të shpërndara nga forca e armës bizantine dhe e varur nga forca e kësaj arme.

Ndarja e kishës në përgjithësi ndikoi edhe në jetën politike. Ng kapërcyelli i shekullit XII, antagonizmat latino-grek në troje arbënore ishin shumë evidente. Faktor kryesor ishte sidomos debimi i latinëve nga Konstandinopojë. Mirëpo, në atë kohë përgatiteshin planet edhe në Perëndim, për rimëkëmbjen e Perandorisë Latine të Konstandinopojës. Por, prapëseprapë politika e gjithëmbarshe nuk varej vetëm nga motivet kishtaropolitike. Këtë, duke qenë e preokupuar me restaurim dhe luftëra në provinca dhe shtete latine në Greqi të Mesme e More, si dhe turqve, që kishin pushtuar gati tërë Azinë e Vogël, Perandoria Bizantine, në kushte të krijuara asesi nuk kishte mundësi të zgjeronte ndikimin e qytetërimit të vet jashtë kufijve të saj. Mirëpo, kontributi i Bizantit në formimin e kushteve kulturore nuk ishte i varur nga fuqia e atëherëshme perandorake. Por, ishte rezultat i luftës dhe i angazhimit nga shekujt e mëparshëm.

Rezultatet e luftës që u zhvillua në Bizant gjatë shekullit VII-XII janë të rëndësishme për problematikën që kemi në shqyrtim, meqë atëbotë u vendos sistemi dhe lidhjet, me të cilët pak ose shumë ishin në varshmëri me vete, shtetet dhe bashkësitë prej Istrie e deri në Detin e Zi. Ky territor i gjerë ishte pjesë e atij sistemi specifik të shteteve, të cilat ndonjë studiues serioz i quante me emër Komonvelti Bizantin.

## Formacionet shtetërore rajonale

Në këtë ambient krishterim ishte edhe kthesë qëndrore për mënyrën e jetës dhe kulturës së popullit të transformuar. Studiuesit e Perandorisë Bizantine për metodat që i përdornin bizantinët rreth krijtes kishtarë të popullit të nënshtuar shihnin dy orjentime të kundërta: i pari krijonte mu-

ndësi për zhvillimin e kulturës autonome, duke respektuar gjuhën e popujve të transformuar, dhe i dyti, ndërkaq kishte tendencë për helenizimin dhe asimilimin kulturor. Që të dy procedimet ofronin rezultatet e dëshiruara, sidomos te popujt e ardhur dhe më pak te popullata autoktone, meqë fillet e krishterimit në trojet iliro-arbërore kishin zënë fill shumë më herët se themelimi i Bizantit.

Rezultatet e përpjekjeve bizantine, që u theksuan më sipër u vunë në sprovë në fund të shekullit XII dhe në fillim të shekullit XIII, kur ishte thyer fuqia ushtarake e politikë e Bizantit. Atëbotë, u dëshmuar se së bashku me marrëdhëniet politike u ndërprenë edhe rrymimet kulturore, sidomos në troje të Shqipërisë së Mesme dhe Veriore, duke përfshirë këtu edhe pjesë të Kosovës. Aq më parë kur dihet se nga kapërcyelli i shekullit XII doli shteti i pavarur i Arbërit, që ishte rezultat i pasojave pozitive dhe atyre negative ndërkombëtare, me të cilat që e lidhur ekzistenca e këtij formacioni shtetërorë. Gjithashtu, pas një numër të marrëveshjeve të posaçme midis anzhuinëve dhe sundimtarëve shqiptarë të bëra gjatë viteve 1269 dhe 1273 doli formacioni shtetërorë “Regnum Albaniae” (“Mretëria Arbërisë”) nën sovranitetin anzhuin. Është me interes të theksohet se në këtë rast forcat politike arbënore morën pjesë pothuaj pa përjashtim në këtë politikë, ashtu siç patën vepruar edhe një pjesë e kryezotërinjëve të Moresë, kur përfunduan marrëveshjet të tilla me sundimtarët frankë. Edhe në këtë rast, sikur në marrëveshjet e mëparshme me sunduesit e huaj të Lindjes e të Perëndimit, prelatëve, kon-tëve, baronëve, kështjellave dhe bashkësive të mëdha fisnore, qyteteve, iu sigurua mbrojtje e privilegjeve të tyre dhe respektimi i institucioneve tradicionale vendase. Me fjalë të tjera, në aspektin formalo-juridik, Mbretëria e Arbërisë, e krijuar me 1272 nga Karl Anzhu, ishte një vazhdim i një tradite ekzistuese shtetërore.

Edhe pse me rrënimin e Perandorisë Bizantine, të Perandorisë së Stefan Dushanit, pushtetit territorial të anzhuinëve, dolën në dritë formacionet shtetërore rajonale, si p.sh., e Balshajve, Topiajve, Muzakajve, prapëseprapë presioni politik i vazhdueshëm i këtyre shteteve të Lindjes e të Perëndimit dhe ndikimi i kulturave që ato përfaqësonin, luajtën një rol negativ frenues që

“ Nga radhët e sipërme mund të provohet se, mes Lindjes dhe Perëndimit ekzistonin dallime genësore rreth mundësive dhe forcave të ndikimit të tyre në hapsirën mesjetare arbënore. ”

Perandorinë Bizantine të shkatërruar, ngritën kryqtarët shtete apo principata latine të tipit feudal perëndimor ku përfshiheshin edhe troje arbërore të asaj kohe. Një grup tjetër të njerëzve të ardhur nga Perëndimi në trojet shqiptare paraqisnin tregtarët. Pjesa dërmuese e tyre erdhi nga Ragusa, Venediku, Gjenova, Ankona, Frience, Zara, Barcelona, Napoli, Amalfi, Rimini, Bari etj. Mirëpo, erdhën këtu tregtarë e zejtarë edhe nga Gjermania, Anglia, Franca, Holanda etj. Perëndimi i sollti trojeve tona etnike edhe një numër të konsideruar, por mjaft vital dhe të zellshëm të gjermanëve (saksëve), të cilët, sidomos në minierat e Kosovës bënë emër të xehetarëve të mirënjohur. Saksët ngritën dhe aktivizuan në këto anë ekonomi xehetare që shpente në zhvillimin e mëtejshëm ekonomik të trojeve, si dhe në lidhjet e tyre me Mesdheun dhe pjesë të tjera të Evropës.

Nga radhët e sipërme mund të provohet se, mes Lindjes dhe Perëndimit ekzistonin dallime

katolik. Ata i lidhte tradita religjioze, tipi identik i organizimit kishtarë, ritualet dhe përafërsisht gjuha identike, si dhe obligimi në besnikërinë ndaj papait. Raportet e përmendura mund të konsiderohen si faktorë mjaft i fuqishëm, sidomos nëse merret parasysh edhe tradita e njejtë kulturore, si p.sh., literatura dhe artet latine me trajta identike stileshe. Një gjë e këtillë në sy të bashkohësve, edhe pse në gjuhë dhe tipare të tjera, i lidhte në një grup të përbashkët, që shpeshherë identifikohet me emër latin, luftëtarë kundër traditave kishtarë ortodokse-bizantine.

## Dualizmi kulturor dhe politik

Ndarja e kishave që zuri fill që nga periudha e krishterimit të hershëm, zyrtarisht u pranua në vitin 1054, si dhe Kryqëzata e Katërtë (1202-1204), thelluan kundërthënien dhe sollën ngatërses të mëdha politike. Në këto kushte manifestohet dualizmi midis Lindjes dhe Perëndimit edhe në



*Në vigjilje të Ditës së Flamurit*

# Nëntorët e hartës së gjeografisë shqiptare

■ SHKRUAN:  
Mikel GOJANI

i pengoi formacionet politike-shtetërore arbërore të dilnin në skenën e historisë si shtete të lira, të cenin më shpejt të rrugën e krijimit të një pushteti politik unik për të gjitha trojet e banuara nga arbërit.

## Strukturë e qëndrueshme etnokulturore

Pesëkëndëshi i madh përreth Durrësit dhe rrugët e tij me këndet Lezhë-Durrës-Ohër-Berat-Vlorë, gjatë tërës mesjetës, ishte rregullues i vërtetë për depërtimin e elementeve të botës Lindore e Perëndimore. Këndej depërtuan, natyrisht, kur u mëkëmbën, bullgarët e serbët. Këndej drejtuan fuqinë pushtuesit normanë, hohenshtaufë, anzuin dhe italian. Këndej zhvilluan aktivitetet shpirtërore-kishtarë edhe papët e Romës.

Qytetet e përmendura gjatë mesjetës kishin rëndësi të shumëfishme. Më i rëndësishmi ishte Durrësi me pamje të vjetër të ruajtur nga antikiteti, ku elementi latin mbante njëpeshimin e simbiozës iliro-arbërore-bizantine. Në këto kushte, nga kaosi etnik i krijuar në Ballkan, në histori hyri edhe populli i Arbërit, i cili në antikitet ishte një faktorë i fortë i historisë. Pas pushtimit të Ballkanit nga romakët, në troje jugore ilire vëreheshin tri zona: Zona Jugore, me koloni helene e me qytete ilire të gjysmëhelenuara; në Veri të Durrësit e të Lezhës shtriheshin Zona Qendrore ilire, e cila karakterizohej me numër të madh të kështjellave, me fise dhe dinasti. Këtu u krijuan edhe mbretëritë ilire: e Agronit, Teutës dhe e Gencit. Në veriperëndim dhe veri të kësaj zone, shtriheshin Zona Dalmatine dhe Dardane, me burim mbretërishtë, fisesh e qendrash të njohura. Populli në fjalë u zhduk për syrin e historikruesve ndër pështjetilimet ballkanike, por fshihura, gjithëherë bashkëpunonte me zhvillimet gjuhësore e folklorike të kombeve ballkanike, për t'u shndërruar më në fund në Arbër, ofronte shenja të reja të fuqisë së vet krijuese. Edhe pse trojet iliro-arbërore u gjenden midis Lindjes dhe Perëndimit (sipas modelit të perandorit Teodos), si dhe u sunduan kohë pas kohe, asnjëherë nuk kanë mundur ta ndryshonin në thelb strukturën etnokulturore të kristalizuar ndër shekuj të kombësive shqiptare. Nuk kanë mundur ta ndërpresin as rrugën e zhvillimit politik, as t'i asimilojnë dhe as t'i shpëpusin nga komuniteti kulturor evropian.

Datat që kanë lënë vulën e tyre nëpër rrugëtimin historik të një populli në fusha të ndryshme të historisë, kulturës, artit, apo të ngjarjeve të ndryshme, që paraqesin akte të rëndësishme të traditës kulturore e historike; janë një moment i veçantë përkujtues dhe krijues, që, në mënyrë të drejtpërdrejtë, shprehin shkallën e vetëdijes nacionale dhe të civilizimit të një shoqërie. Datat e këtilla, kur janë në përjesëtim me rëndësinë objektive që ka një ngjarje historike e kulturore e pasurojnë terrenin shkencor, kulturor dhe vizionin historik të një kombi. Edhe ngjarja, e cila gjendet në vigjilje, 28 Nëntorit – Ditës së Flamurit Kombëtar, paraqet një nga ngjarjet më të rëndësishme të historiografisë sonë kombëtare, gjë që konsiderohet si një nga fitoret më të mëdha të popullit shqiptar.

## Gjeneza e Nëntorit të Parë – të Gjergj Kastrioti

Festa e Flamurit, Nëntori i parë, gjenezën pikërisht e ka me Gjergj Kastriotin – Skënderbeun, i cili më 28 – Nëntor të motit 1443 u kthye në Krujë Legjendare dhe një çerek shekulli me sukses korri fitore kundër Perandorisë osmane duke çliruar atdheun dhe duke mbrojtur qytetërimin evropian. Ky flamur, në krye me heroin kombëtar Gjergj Kastriotin, u printe betejave të ashpra kundër armikut shumëfish më të madh dhe më të fortë. Kështu, Flamuri i kuq me shkabën dykrenore u bë simbol i qëndrës, simbol i atdhedashurisë. Plot pesëqind e ca vjet sa zgjati robëria otomane, për aq vjet populli shqiptar u gjakos dhe në një moment erdhi ora e lirisë, ku më 28-Nëntor 1912 nën udhëheqjen e të Mëdhënjës, Ismail Qemalit, të Luigj Gurakuqit, dom Nikollë Kacorrit dhe të shumë atdhetarëve të tjerë të paepur ngritën Flamurin e Lirisë – Flamurin e Gjergjit të Madh, të ruajtur në zemër, në shpirt dhe mendje. U shpall Pavarësia e Shqipërisë e Veriut, Shqipëria Lindore, Çamëria. Ilirida dhe ngulmime të tjera të gjeografisë sonë mbetën të robëruara nën kthetrat e mbretërive të porsaformuara ballkanike. Prapë vazhdojnë luf-

tërat, gjakimet për liri, sakrificat të mëdha.

## Nëntori i Dytë, përfaqëson fitoren e përbashkët të të gjitha trevave të gjeografisë shqiptare

Ngritja e flamurit kombëtar në Vlorë përfaqëson fitoren e përbashkët të të gjitha trevave të gjeografisë shqiptare, prej Rrafshit të Dukagjinit në veri e deri në Çamëri në jug, prej brigjeve të Adriatikut e të Jonit në perëndim e deri në fushat e Kosovës, të Tetovës, në pellgun e Shkupit, në luginën e Preshevës e të Kumanovës, në lindje. Këto treva, duke marrë pjesë gjallërisht me pushkë e me penë në lëvizjen për çlirim kombëtar, vunë gurë në themelet e pavarësisë shqiptare, i çimentuan ato me gjakun e bijve më të mirë dhe i hapën rrugën formimit të shtetit shqiptar. Me Aktin e 28 Nëntorit 1912 san-



ksionohet e drejta e pamohueshme historike e kombit shqiptar për të qenë i bashkuar, i lirë e i pavarur në trojet e veta, krahas popujve të tjerë të Gadishullit Ballkanik. Kjo ishte një e drejtë që buronte nga qenia e tij si popull me gjuhën, me kulturën, me individualitetin e me historinë e vet, e drejtë e fituar me mundime e sakrificat të panumërta në llogoret e luftës, e drejtë që i takonte për ndihmesën e vyer në dëbimin nga Ballkani të sunduesve të huaj osmanë.

Për ta siguruar një fitore të tillë, popullit shqiptar iu desh të bënte një luftë të gjatë kundër sundimtarëve osmanë dhe synimeve grabitqare të fuqive të huaja. Një varg rrethanash të brendshme e të jashtme kanë bërë që këto lëvizje të mos arrijnin dot objektivin. Por në çdo etapë ato kanë vënë në provë forcat materiale e morale të popullit shqiptar, kanë pasuruar përvojën e traditat e tij luftarakë dhe kanë

krijuar premisat për zhvillimin e mëtejshëm të luftës. Në shek. XIX e në fillim të shek. XX kjo luftë u zhvillua mbi baza të reja shoqërore e politike dhe mori karakter të ndërgjegjshëm kombëtar.

Shpallja e autonomisë nga Lidhja e Prizrenit dhe ajo e Pavarësisë nga Kuvendi i Vlorës më 1912 janë dy hallkat themelore në zinxhirin e ngjarjeve të lëvizjes kombëtare, të lidhura organikisht ndërmjet tyre si shprehje e vullnetit popullor dhe si pasojë e drejtpërdrejtë e përfundim logjik i luftës çlirimtare. Por, Shpallja e Pavarësisë shqiptare ishte në të njëjtën kohë një etapë më e lartë, e përcaktuar nga zhvillimi progresiv i lëvizjes dhe nga rrethanat ndërkombëtare.

Prapambetja ekonomike e shoqërore e vendit ishte padyshim një faktor që vonoi rritjen e forcave organizuese e drejtuese të lëvizjes kombëtare e si pasojë e vështirësioi dhe e vonoi Shpalljen e Pavarësisë. Megjithatë, edhe pse Shqipëria ishte një vend i vogël e mbi të rëndonte zgjedhja e një perandorie të madhe, një faktor themelor që e vonoi për dhjetëra vjet pavarësinë shqiptare ishte ai i jashtëm. Populli shqiptar ka qenë

gjatë gjithë lëvizjes për çlirim kombëtar i vetëm, pa ndihmën e jashtme e pa aleatë. Për më tepër, shtetet ballkanike fqinje, të cilat të parat patën siguruar pavarësinë, luftuan me të gjitha mjetet, duke filluar nga presionet diplomatike e duke mbaruar edhe me ndërhyrje të armatosura, kundër Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, e cila për nga qëllimet e saj ishte në kundërshtim me planet e tyre të skllavërimit ekonomik e politik dhe të copëtimit të Shqipërisë. Edhe Fuqitë e Mëdha, të cilat, gjatë gjithë shek. XIX patën përkrashur popujt e krishterë të Ballkanit (serbët, grekët, rumunët e bullgarët) të formonin shtetet e tyre të pavarura, për një kohë të gjatë, mbajtën një qëndrim mos-përfillës ndaj çështjes shqiptare.

Vendimi historik i 28 Nëntorit drejtohej, megjithatë, jo vetëm kundër politikës së Fuqive të Antantës dhe të shteteve fqinje të Ballkanit, por edhe kundër planeve të fuqive të

Lidhjes Trepalëshe. Këto të fundit, sidomos Austro-Hungaria e Italia, si më të interesuarat për çështjen shqiptare, ishin në atë kohë për autonominë e Shqipërisë, nën sovranitetin e sulltanit. "Pavarësinë" e saj ato e shihnin si një variant të mundshëm të zgjidhjes së çështjes shqiptare dhe e kuptonin nën prizmin e interesave të vet, si mjetin që do t'u hapte rrugën për të vendosur kontrollin ekonomik e politik mbi Shqipërinë, për ta përdorur popullin shqiptar si gardh kundër shtrirjes së shteteve sllave dhe të bashkonte në një shtet të vetëm gjithë territoret e popullsinë shqiptare, duke krijuar pas pesë shekujsh robërie Shtetin e Pavarur Shqiptar përbën ngjarjen më të madhe, unike, në historinë e kombit shqiptar gjatë shek. XX. Kthesa historike e 28 Nëntorit 1912 ishte premisa politike themelore për organizimin mbi baza më të përparura të jetës shtetërore të pavarur të shqiptarëve dhe për zhvillimin më të shpejtë ekonomik, shoqëror e kulturor të vendit. Duke formuar Shtetin e Pavarur Shqiptar ajo objektivisht krijoi gjithashtu premisat dhe atë bazë shtetërore e politike, aq të nevojshme për ta mbajtur të gjallë çështjen e çlirimit dhe të bashkimit të të gjitha trevave shqiptare dhe për zgjidhjen përfundimtare të problemit shqiptar në Ballkan.

## Nëntori i Tretë i lirisë së Kosovës

Për Kosovën, viti 1999 paraqet nëntorin e Tretë të Lirisë, pasi që më në fund mbërriti Ora e Madhe e Lirisë. Pas gjithë gjithë atij rrugëtimi për një gjakim të vetëm, u sblumua me krijimin e shtetit të ri, i cili u lind në Ballkanin Perëndimor, – e ai është shteti i Kosovës së Pavarur dhe sovranë. Festa e Flamurit, 28 – Nëntori gjithmonë tek në shqiptarët sjell momentin e rikujtimit dhe të respektimit me pietet të historisë sonë të lavdishme, të cilën e karakterizon gjithmonë aspirata e vetme e lirisdashjes dhe mvetërsisë së një populli, aspiratë kjo që është mbajtur gjallë ndër shekuj dhe nuk është shuar kurrë deri në realizimin e saj të paradokshshëm.

# Presidenti Wilson dhe çështja shqiptare 1919-1920

■ SHKRUAN:  
Prof. dr. Lush CULA

Në historinë botërore, sikur u bë dukuri që pas çdo lufte, palët ndërlyftuese të ulen në tryezat e bisedimeve e t'i zgjidhnin çështjet, të cilat rëndom ishin shkaktoare të luftërave disavjeçare. E tillë ishte edhe Konferenca e Versajës e organizuar nga 18 janari 1919 gjer më 21 janar 1920. Motoja e kësaj konference ishte dhënia fund e gjendjes së luftës ndërmjet palëve të konfrontuara: shteteve të Antantës nga njëra anë dhe atyre të Bllokut Qendror nga ana e tjetër. Konferenca që në fillim u kthye në arenë grindjesh ndërmjet fuqive fituese për shkak të ndarjes së plaçkës së luftës. Në ato rrethana, rreziku i copëtimit të Shqipërisë u bë më kërcënues se kurrë më parë. Drejtimin e rrjedhës së ngjarjeve do ta vendosnin disa faktorë të brendshëm dhe të jashtëm, kurse faktori i jashtëm nuk i përkrahte kërkesat legjitime të shqiptarëve.

Në situatën e tillë të krijuar në Evropë, ku kishte antagonizma të mëdhenj dhe ku ndesheshin interesa të ndryshme, idetë e reja, që presidenti Wilson sillte nga SHBA-ja në politikën botërore, nuk buronin nga bekgaranditë e tij ideologjik, sepse ai nuk kishte aspak të bënte me socialistët evropianë, por buronin nga prirja e tij shumë përparimtare e vizionare për një botë në paqe, prosperitet dhe për një politikë të bazuar në një moral të lartë njerëzor. Doktrina e Wilsonit shprehte në thelb qëndrimin amerikan kundër konceptit evropian të ekuilibrit të forcës dhe imoralitetit të zbatimit të realpolitikës. Wilsoni dhe Amerika ishin për një rend të ri botëror të dominuar nga demokracia, nga sigurimi kolektiv dhe e drejta e popujve për vetëvendosje.

Presidenti Wilson kishte mbajtur një konferencë të kombeve të shtypura në Washington, më 4 korrik 1918, me rastin e ditëlindjes së Xhorxh Washingtonit. Fan Noli e përfaqësonte Shqipërinë në atë takim. Aty Noli kishte biseduar me presidentin Wilson, duke i folur për pavarësinë e Shqipërisë. Wilsoni i kishte thënë: "Unë do ta kem vetëm një zë në Konferencën e Paqes dhe unë do ta përdorë zërin tim në të mirë të Shqipërisë."

Që më 18 dhjetor 1918, një ndër anëtarët më të shquar të Komitetit të Kosovës, Hasan Prishtina, i drejtohet me një telegram presidentit Wilson në Paris. Në emër të popullit shqiptar kërkon mbrojtjen e drejtave të popullit të vet në Konferencën e Paqes dhe gjetjen e mundësi-

së për t'i paraqitur argumentet nëpërmjet përfaqësuesit shqiptar, duke theksuar padrejtësinë e madhe me vendime skandalozë të marra në Konferencën e Londrës, ku shumica e shqiptarëve mbetën jashtë kufijve të shtetit shqiptar.

Në Arkivin Qendror të Shtetit Shqiptar ruhen mjaft dokumente origjinale që bëjnë fjalë pikërisht për kërkesat e shqiptarëve drejtuar Qeverisë amerikane për mbështetje të interesave të saj. Edhe kryetari i delegacionit qeveritar të Durrësit në Konferencën e Paqes, në fillim të marsit 1919, kërkon mandatin amerikan për Shqipërinë, i cili duhej t'i përfshinte si Çamërinë e okupuar nga ushtria greke, ashtu edhe trojet shqiptare të Veriut dhe të Lindjes, të aneksuara nga serbët dhe malazezët, dhe se gjatë mandatit amerikan popullsia e këtyre trojeve të ketë të drejtë ta organizojë plebishitin.

Në Paris kundërtënimet ndërmjet presidentit Wilson dhe udhëheqësve të Konferencës së Paqes ishin shumë të mëdha, sepse këta nuk pajtoheshin me parimet dhe 14 pikat e tij.

Wilsoni identifikoi, në mënyrë të saktë, disa nga sfidat kryesore të shekullit XX, në mënyrë të veçantë se si mund të vihej forca në shërbim të paqes.

Vlen të theksohet se, me gjithë shkrështet dhe memorandumet e ndryshme të shqiptarëve, fatkeqësisht përfaqësuesit amerikanë çështjen shqiptare në përgjithësi dhe atë të Kosovës në veçanti, asokohe nuk e njihnin sa duhej. Madje, atë e njihnin me ngjyra shumë të errëta, siç e paraqiste literatura voluminoze dhe me përmbajtje kryesisht propagandistike, e shkruar nga autorë të vendeve fqinje.

Formula e Versajës, me përpjekjen e pamoralshme për të hedhur gjithë përgjegjësinë e Luftës së Parë mbi Gjermaninë dhe për t'i ndëshkuar në mënyrë të paarsyeshme të gjitha vendet e tjera të lidhura me pellgun e Evropës Qendrore deri në Evropën Juglindore, bëri në fakt minimumin e procesit të sigurimit evropian në atë masë sa vetëm pak vite do të kalonin dhe kontinenti e bashkë me të edhe e tërë bota do të përfshiheshin në një luftë me përmasa të papara në histori-në e njerëzimit.

Wilsoni nuk u pajtua me

kompromisin e janarit të vitit 1920 të partnerëve evropianë, ku parashikohej një copëtim më i thellë i trojeve të shtetit shqiptar nga sa ishin menduar në projektet e mëparshme të hartuara në Konferencë.

Për Wilsonin përmbajtja e këtij memorandumit "ruante deri në një farë mase unitetin e shtetit shqiptar", meqë në të nuk prekehshin kufijtë veriorë të Shqipërisë, çfarë ishte parashikuar në kompromisin e 14 janarit të vitit 1920. Wilsoni u kërkoi partnerëve evropianë të hiqnin dorë nga kompromisi i tyre i 14 janarit të vitit 1920 dhe të ktheheshin te memorandumit i 9 dhjetorit të vitit 1919, që ishte hartuar bashkërisht me partnerët amerikanë.



Presidenti Wilson

Ishte koha e përgatitjes së luftës së Vlorës, si mijet i vetëm që kish të mbetur për t'iu kundërvënë projekteve të Paqes së Versajës, të cilat cenonin rëndë pavarësinë dhe tërësinë territoriale të shtetit shqiptar.

Në gjysmën e dytë të janarit marrëdhëniet ndërmjet presidentit Wilson dhe kryeministrit të Francës dhe Britanisë së Madhe kalonin momente tensioni dhe krize.

Vudro Wilson vdiq më 3 shkurt të vitit 1924. Të nesërmen, më 4 shkurt, në Kuvendin Kushtetues në Tiranë, u propozua mbajtja e 5 minutave heshtje në kujtim të tij. Jehona e vdekjes së tij u pasqyrua menjëherë edhe në shtypin shqiptar. Mbi personalitetin e Wilsonit do të flitej përsëri në Kuvendin Kushtetues pas disa ditësh (11 shkurt) nga Fan Noli, i cili foli me shumë pasion për presidentin Wilson. Noli, ndër të tjera, theksoi: "Në janar të vitit 1920, një erë zie dhe dëshpërimi kish rënë mbi të gjithë anët e vendit tonë, i cili që si një i vdekur në agoni. Projekti i copëtimit të Shqipërisë i redak-

tuar nga katër aleatët evropianë, ishte njohur dhe priste vetëm një firmë që të bëhej një fakt definitiv. Firma që mungonte ishte ajo e presidentit Wilson, firmë që nuk u vu në atë projekt aq të pa drejtë." Fjalimi i Nolit në Parlament u shoqërua me duartrokitje, që ishte një tregues i qartë se si u prit ky fjalim, por pati edhe reagime dhe një ndër ata që replikoi, ishte deputeti Hil Mosi, që shprehu shumë rezervë ndaj vlerësimit aq të lartë që Noli ia bëri rolit të Wilsonit në mbrojtje të çështjes kombëtare shqiptare. Ai ndër të tjera do të theksonte: "Wilsoni që ai që pronte që Fiumja t'i jepej Jugosllavisë të u lanë Vlorën Italisë e viset e Jugës Greqisë."

Kundër kritikuesve të presidentit Wilson më ashpër ishte shprehur Faik Konica, kur theksonte: "Jemi të bindur se çdo shqiptar di dhe kupton se ç'borg të madh i kemi Wilsonit. Në qoftë se ka ndonjë shqiptar që s'merr vesh se shtetimi dhe liria e vendit (të) tij i detyrohet kryesisht Wilsonit, ai nuk është njeri dhe duhet të kemi meshirë për verbësinë dhe errësinë që i ka mbuluar trutë." Ai më tutje do të theksonte: "Shqipëria ishte dënuar me vdekje, dënimi do të zbatohet doemos, asnjë rreze shprese s'ndritte gjëkund. Por e papritura ngjau, dhe

kjo e papritur erdhi nga qëndrimi i Vudro Wilsonit, vjonte me tëj Faik Konica. "Ndërgjegjja e drejtësisë njohu përsëri zërin e madh, dhe u drodh nga gëzimi; se Wilsoni duke e mbrojtur Shqipërinë nuk e mbronte një popull të vetëm, por mbronte gjithë popujt, e mbronte parimin". Ndërkaq gazeta "Dielli" e datës 25 mars 1924, duke iu kundërvënë diskutimit të Hil Mosit në Parlament do të theksonte ndër të tjera: "E qortoi Wilsonin se ai i dha Vlorën Italisë, ndonëse çdo njeri duhej të kuptonte, dhe shumë kuptojnë, që dhe Vlorën Wilsoni e shpatoi terthori: se po të mos kish ngulur këmbë Wilsoni që të bëhej një Shqipëri, s'mund t'i jepej kurrë rasti as Vlorës që të shpëtonte nga zgjedhja italiane".

Përgjithësisht pasqyrimi i figurës së Wilsonit në qarqet shqiptare është parë nga dy dimensionet të kundërta. Është dhënë si figurë që i kontribui çështjes shqiptare dhe si figurë që nuk ndihmoi në të mirë të saj. Kemi të bëjmë me një pasqyrim të ngjashëm me atë që është

vënë në dukje nga studiuesit: se në realizimin e programit të tij në plan evropian dhe botëror Wilsoni me shumë dështoi sesa fitoi për shkak të opozitës evropiane në radhë të parë.

Konferenca e Parisit 1919-1920 e ndryshoi hartën politike të Evropës, Azisë dhe Afrikës. Populli shqiptar dhe përfaqësuesit e tij ishin aktivë dhe për rrethanat e kohës arritën atë që mund ta arrinin. Rezultatet e këtyre arritjeve nuk janë për t'u nënvlerësuar. Madje, po ta kemi parasysh raportin e pabarabartë të forcave dhe rrethanat e tjera u arrit aq sa nuk shpeshohej. Shqipëria vërtet mbeti si shtet i ndarë pa pjesët më vitale të saj, sepse u morën për bazë argumentet politike, por të paktën u arrit që të rifitohej pavarësia e vendit dhe sidomos të mënjanohejshin padrejtësi të reja territoriale që do të ishin tragjedi e dyfishtë për të ardhmen e kombit.

Mbi të gjitha vlen për tu veçuar fjalimi i Fan Nolit në Parlamentin shqiptar me 11 shkurt 1924 ku ndër të tjera do të theksonte: "Amerika dhe tërë bota vajtuan keto ditë vdekjen e Woodrow Wilsonit. Pranë Amerikës merr pjesë në këtë zi edhe Shqipëria, e cila e quan amerikanin e madh, idealistin bujar dhe mbrojtësin e saj më të fortë. Presidenti Wilson provoi në shekullin e XX se ka një vend i cili edhe prodhon kalorës bujarë për t'iu mbrojtur jetimit, të vejtave dhe të shtypurit. Qysh ta quajmë e ta vajtojmë këtë kalorës pa frikë e pa njollë, chevalier sans peur ni reproche! Amerika, ajo nënë bujare që i dha Botës Wilsonin ka për të lindur edhe të tjerë kalorës si ai, kalorës të cilët do të vazhdojnë të përfundojnë veprën e Paqes, e vëllazërimit, dhe mirëdashjes ndërkombëtare".

Profesia e madhe e Nolit se "Amerika, ajo nënë bujare që i ka dhënë Botës Wilsonin, ka për të lindur edhe të tjerë kalorës si ai u jetësua pas 75 vitesh. Amerika e Madhe lindi kryekalorësin Bill Klinton, burrë i madh i shekullit që ishte në ballë të aksionit për t'i sjellë lirinë qytetarëve të Kosovës."

Përfundimisht mund të theksohet se mbështetja nga ana e SHBA-së dhe presidentit Wilson, e shumëkërkuar dhe e shumëdëshiruar nga shqiptarët, nuk ishte ajo që prisnin shqiptarët. Pikërisht në atë periudhë kohore, edhe pse Amerika ishte një fuqi ekonomike gjithnjë e më rritje, akoma nuk ishte fuqi e rëndësishme politike botërore. Ndikimi dhe pesha reale e këtij vendi të madh në vendimmarrjet më të rëndësishme të botës do të ndihej me vonë e në veçanti pas Luftës së Dytë Botërore.



Vështrim për librin e Yves Iwonides: Pali i Tarsit Vigani i Krishterimit

# Shndërrimi njerëzor para Hyjnores

Pikërisht në vitin Jubilar të shpallur nga Papa Benedikti i XVI si viti i shën Palit, lexuesit tanë i pajis me një libër të përmasave shkencore-teologjike, të cilën na e sjell françeskani, teologu, shkrimtari, redaktori dhe poeti kroat Yves Iwonides (Ivon ÇUK), „Pali i Tarsit, Vigani i Krishterimit”. Është ky libër, i cili na mundëson ta kuptojmë përvojën intime të këtij shenjt, me qëllim që t'i pranojmë falët e Ungjillit ashtu siç ka bërë Shën Pali. Librin e ka përkthyer dr. Don Prekë Lazraj –drejtor i Radio Marisë në Shkodër. Botoi; Enti botues Gjergj Fishta, dhe ka 196 faqe.

■ SHKRUAN:  
Wilson CULA

Libri i autorit kroat Ivon Çuk, „Pali i Tarsit Vigani i Krishterimit” na vjen si margaritar i çmuar, apo të themi kushtimisht, si një roman historiko-teologjik i rrëfimitarit. Është kjo vepër që e bën edhe sot aktual jetën, veprën, përkushtimin, sakrificën, mendimin, por, mbi të gjitha, fenë dhe ngadhënjimin shpirtëror të Shën Palit apo Ungjillëzuesit të kombeve pagane. Është ky Shën Pali apo shenja e mbikohës, i cili me kthimin dhe sakrificën e tij, dha shembullin e tij se si duhet Zoti dhe qëllimi hyjnor para dëshirave tokësore dhe të përkohshme. Libri i IVON ÇUK është i ndarë apo i konceptuar në 17 pjesë, të cilat hollësisht shkojnë në detaje nga jeta e Shën Palit, duke e përfshirë që nga lindja e tij në Tars e deri tek martirizimi i tij tek Moçali i SALVIT. Në pjesën e parë përshkruhet fëmijëria e Saulit, edukimi si hebre, krenaria dhe egërsia e tij, si dhe përvojat ndaj popujve tjerë. I etur për dije dhe plot talent, babai i tij e dërgon në Jerusalemin tek mësuesi Gamaliele, ku Sauli përgatitet me dije të larmishme. Pjesa e dytë përshkruan kthimin e Saulit të pjekur në Jerusalemin, por tani jo më si nxënës, por si persekutues i krishterimit, ku e trondit pa masë vrasja e Shën Shtefjnit, martirit të parë të Krishtit, të cilin e kishte pasur edhe shok shkolle. Në pjesën e tretë përshkruhet rruga për në Damask, kur Sauli përjetoi shndërrimin hyjnor, kthimin dhe shërimin nga prifti Anania. Këtu do të ndërpritet edhe tërë pengesat intelektuale të Saulit hebre e bir fariseu për të filluar një jetë të re për amshim. Për këtë Shën Augustini më vonë do të shprehë: „Duke e goditur e shëroi, duke e vrarë e ringjalli”. Ishte momenti kur Sauli mendjehollë dhe Rabin i radikalizuar, jetën e tij do ta ndante në dy pjesë, pa Krishtin dhe në Krishtin. Këtu hyjnë edhe pagëzimi sakramental e periudha deri tek vërshimet për t'u adaptuar në jetën e re me vëllezërit e krishterë. Pjesa e katërt paraqet habinë që e përjetoi Damasku me rastin e kthimit të tij, dhe ikjen e Palit në Arabi. Atje bëri tri vite dhe më vonë për t'u kthyer në misionin e tij të përjetshëm. Pali i ndarë mes botës intelektuale dhe ndjenjave personale, vendos të vdesë për Krishtin. Pjesa e pestë përshkruan

paraqitjen e Palit në Sinagogë, kundërshtitë e hebrejve, rrahjet, fyerjet dhe tentativën për ta vorrë Palin. Gjatë shtegimit rrugës Via Maris, më vonë Pali takon Barnaben dhe Shën Pjetrin, burimin e parë të ngjarjes së Jezu Krishtit. Pjesa e gjashtë shqyrton pjesën më dramatike të jetës së Palit. Ai nuk mundte të heshte para nxitjes hyjnore, predikoi në Sinagogën e Libertinëve, në atë vend ku kundërshtitë e ideve dhe rragatjet fetare përfundonin me grushte e thika. Për Palin nuk kishte më vend në Jerusalemin, ku tradita e prishur dhe kufizimi kombëtar nuk i linte vend fesë së gjallë. Kthimi në Tars i solli dhimbje të madhe. I nënçmuar nga rrethi dhe i dëbuar nga familja, detyrohet të jetojë në shpellë. Freski i sjell ardhja e Barnabës ku me të e vazhdon misionin në Antioki e ku bashkësitë e krishtera po rriteshin si fara e sinapit.

Në pjesën e shtatë përshkruhet misionariteti i Palit dhe Barnabës në Antioki përballë kulteve, mistereve pagane, hedonizmit, lojërave e procesioneve. Prej një personi të urryer, Shën Pali shndërrohet e një person të nevojshëm. Këtu përshkruhet takimi i Palit në prokonsullin Romak Sergji dhe magjistarët e ndryshëm, ku Pali ngadhënjën mbi ta me fuqinë e shpirtit të shenjtë. Fjala e Palit bëri që të kthehej edhe prokonsulli në krishterim. Edhe këtu nuk mungoi frushkullimi, por Pali nuk e ndaloi misionin e tij të shenjtë. Pjesën e tetë autori e quan „Gjarpri në dje” - përshkruhet ndërhyrja e elementeve të jashtme pagane në krishterim dhe të traditave të hebraizmit të lashtë. Këtu lind edhe kontesti i rrethprerjes, ku Jakobi në këtë rast anonte nga konservatorët. Moment i thyerjes shpirtërore ishte për Palin, kur Pjetri filloi të tërhiqej nga qëndrimet e mëparshme...

Mu aty lind edhe thyerja mes dy viganëve dhe problemi ishte se Pjetri nuk i njohte njerëzit nga singjeriteti, kurse Pali me inteligjencën e tij - po. Më në fund këta dy viganë u bënë miq të vërtetë dhe i hapën rrugën kishës universale brenda lavdisë hyjnore. Në pjesën e nëntë përshkruhet rruga e Palit drejt Evropës dhe ndarja e përmallshme me Barnaben shkaku i Markut...ngjarje që e theu në zemër. Barnaba ishte pedagog, kurse Pali e sfidoonte vdekjen. Arritja e Palit në Trojë ia solli njohjen me Lukën mjek,

shkrimtar dhe të ditur. Stacioni i parë i Shën Palit na del Neopoli dhe më vonë Kavala. Këtu ndodh edhe pagëzimi i Lidisë. Ishte ungjillëzimi i parë përmes një gruaje në Evropë. As këtu nuk munguan frushkullimet dhe torturat. Synimi i tij ishte Selaniku. Edhe këtu pasuan revoltat. Pas ikjes pasoi Athina apo qyteti i pashpirt, siç e quante Shën Pali. Këtu apostulli të madh iu mundësua të fliste pranë Senatit Grek. Më pas pason revolta në Sinagogë. Pali këtu përdori strategjinë, në vend të fjalës së gjallë përdori fjalën e shkruar. Këtu zë fill Letra dërguar Romakëve. Në pjesën e dhjetë autori paraqet qëndrimin e Palit në Efes, ku e presin kundërshtarë hebrej të kthyer më parë në krishterim. Ata përdorën kërcënime. Në vendin ku lulëzonte krimi, magjia, kultet e misteret, perandorin e çmonin për Zot. Teozofia, okultizmi e magjia e zezë kishte shumë ihtarë. Këtu apostulli në vend të fjalës së gjallë, përdori mrekullinë përmes fuqisë së shpirtit të shenjtë. Nga ky kthim shpirtëror ndodhi mrekullia. Të gjithë librat e magjisë u dogjën nga qytetarët. Për këtë Pali u akuzua nga Demetri, kinse po ua cenonte zotat. Në ndihmë i erdhi Aleksandri ku mezi shpëtoi kokën. Më pas Efezi u bë vend i krishterë. Në pjesën e njëmbëdhjetë përshkruhet paqja relative e jetës së krishterë dhe përballja e Palit me zelotët-thikatarë. Për këtë në vend që t'i festonte Pashkët në JERUZALEM, Pali u ndal në Filipe. Mu këtu do të plotësohej edhe profecia e Agabit për vuajtjet e Palit. Hebrejntë vendorë e akuzonin Palin se kishte bërë blasfemi si i kishte lejuar grekët të hyjnë në Tempull e Sinagogë. Pali këtu përjetoi ferrin e tokës. E goditën me gurë dhe e tërhoqën zvarrë. Shpëtimi i erdhi nga komandanti romak Lizia. Pali shpëtoi falë asaj që ishte qytetar romak. Pjesa e dymbëdhjetë paraqet dy vite të Palit në Cezare dhe padinë e Li-

disë dërguar Feliksit. Gjykimin e bëri Tertuli. Pasi vërejti se Pali i takonte tokës së perandorisë, vendosi që gjykimi të bëhej para per a -



ndorit. Rruga drejt Romës po hapej. Po plotësohej plani hyjnor pikë për pikë.

Pjesa e trembëdhjetë paraqet arrijtjen e Palit në Romë me anije dhe shpëtimin mrekullibërës të ekuipazhit nga ana e Palit. Në këtë shtjellim hyjnë edhe mikpritja e mrekullueshme e maltezëve, ndër ata gjendej edhe qeveritari Publi, i cili më vonë, falë fuqisë së Palit, u kthye në krishterim. Pjesa e katërmëdhjetë „Paulus Ante Portas” shpjegohet madhështia shpirtërore e Shën Palit. Botës pagane po i afrohej madhështia që do t'ia dridhte themelet Romës për ta themeluar mbretërinë e paqes dhe dashurisë së amshuar. Këtu do të përballohej mësimi hyjnor me shfrenimin, krimin, padrejtësinë, kultin e magjinë. Pali vërejti se njeriu trajtohej si Res Viva dhe se krimi e prostitucioni ishin në kulm. Në atë kohë Romën e sundonte Neroni. Pali iu caktua burgu Custodia Libera pasi që gëzonte të drejtën qytetare romake. Dashuria e përjetshme po priste të pragu i Romës ta pushtonte botën. Në pjesën e pesëmbëdhjetë përshkruhet liri mi i Palit nga burgu në vitin 63. Pali fill vuri kontakt me bashkë-kombësit e tij, që arrinin diku në 30 mijë. Ndër ta u dallua Altisi.

Mu këta çifutë që dikur do bënin që gati të rrënohej -shuhej bashkësia e krishterë në Romë. Ishte koha kur edhe qeveritarët po ktheheshin në krishterim, ndër to edhe ish gruaje e perandorit Neron, e quajtur Akia. Pali këtu takon edhe filozofin Senekën që më vonë u bë mik i Palit. Këtu Pali shkroi Letrën dërguar Filomenit, të cilin Renani e quan perla e krijimtarisë së hershme krishtere. Te Pjesa e gjashtëmbëdhjetë autori paraqet shthurjen e rinisë romake dhe sjelljen e kulteve dhe magjisë lindore në Romë. Roma digjet nga Neroni Paranojak, ku hebrejntë nga fobia fajin ua hedhin të krishterëve. Fljimi nuk mungoi. Pali për fat nuk gjendej në Romë. Si duket, kishte shkuar në Spanjë, pasi që në Jerusalemin dominonte kaosi. Në vitin 66 Pali udhëton në Nikopojë dhe i shkruan Letër Titit.

Në pjesën e fundit paraqitet vdekja apo martirizimi i Shën Palit tek Moçali i Salvit. Në atë kohë Neronin po e zëvendësonte Eliu i pashpirtë. Pali paditje për organizimin e të krishterëve për djegjen e Romës. Pali, fal dijes i shpëtoi gjyqit të parë, por të dytit jo. Pali kërkoi nga Timoteu që t'ia sillte Markun që ta përfaqonte me mall, pasi që e dinte që po kalonte në amshim. Në mëngjesin e 29 qershorit të vitit 67, i prangosur në trup, por jo në shpirt, vigani i krishterimit po udhëtonte drejt VIA OSTIENSISIT ku sot ndodhet Bazilika e shenjtë. Këmbët e apostullit i ecën për herë të fundit, mu ku sot gjendet VIA LAURENTIA, kurse koka i ra mu tek vendi i Tri Fontanave. Këtu e dha jetën dashuria e zjarrtë, e zhytur në dashurinë e Zotit.

Kjo vepër e Ivon ÇUK lexuesit tonë po i jepet si një margaritar i çmuar teologjik dhe historik, i cili do ta ndihmonte që përmes këtij libri ta njohte madhësinë shpirtërore të Shën Palit, kurse përmes apostullit hyjninë e Krishtit dhe sakrificën e të krishterëve të parë. Po ta pyesnim të kaluarën dhe historinë, dhe nëse do të vinte në alternativë shprehja e psikologut Erich From, „të kesh apo të jesh”, lirisht mund të themi se Shën Pali e zgjidhi këtë të dytën. Le t'i ngjasojë pra jeta jonë Shën Palit e shndërruar në Krishtin.

# Përmasat e personalitetit të Tonin Harapit (I)

*“Kompozitor nuk është ai që shkruan muzikë, por ai që nuk mund të qëndrojë pa shkruar muzikë”. Tonin Harapi*

■ SHKRUAN:  
Akil Mark KOCI/ Londër

Në fushën e krijimitarisë muzikore shqiptare kemi ca emra, pa të cilët nuk mund të mendohet kjo fushë e artit, sepse me krijimtarinë e tyre të gjithanshme, për dekada me radhë, duke e pasuruar fondin e artë muzikor, kanë hyrë me nder e dinjitet në Panteonin e këtij arti. Bëhet fjalë për një opus me frymëmarrje të gjerë, me cilësi artistike majkapëse, që vezullon në qiellin e kthjellët të kulturës së gjithëmbarshe shqiptare. Mesazhi i tyre në këtë art kaq të bukur, kaq tërheqës dhe njëherazi kaq të vështirë, na është përcjellë e na është kumtuar përmes derdhjes, si ujëvarë, e frymëzimit të mirëfilltë në gjeni nga më të larmishmet.

“Gjatë shkëmbimit të mendimeve me këngëtarë e sidomos me solistë, Tonin Harapi i këshillonte që edhe në shtëpi e kudo, të mos e shkëputnin vëmendjen nga pjesët e repertorit të tyre; të ushtroheshin e të përsërisnin pa pushim fragmente e pasazhe, jo vetëm nga pjesët që u kërkoheshin për koncerte të ndryshme, por sidomos nga vepra muzikore të famshme.”

Cilat janë gjinitë që ka lëvruar Tonin Harapi? Më e saktë do të ishte pyetja: cilat janë ato gjeni që nuk i ka lëvruar Tonin Harapi? Sepse, praktikisht, ky mjeshtrë i madh i zhdërvjelltësimi të pen-tagramit, ky “zgjerues” i jashtëzakonshëm i katër “fushave” të ndryra brenda pesë vijave, praktikisht është i pranishëm, me tërë forcën e talentit të vet, në të gjithë gamën e zhanreve të muzikës, duke filluar nga kënga në frymën e muzikës popullore, argëtuese, klasike e deri në ato më të sofistikuarat, në muzikën kamerale, simfonike dhe skenike...

Artist i lindur, me një muzikalitet të pasqorë e me një zgjuarsiri të jashtëzakonshme, Tonin Ha-

rapi ka qenë i pajisur me aftësi të rralla për t’iu përgjigjur kërkesave të shumta stilistike. Duke qenë gjithmonë rigoroz në profesion, pedant në kuptimin pozitiv të termit, Tonin Harapi ia kishte ënda të ndalej në zbërthimin e shkoqitjen e termave muzikorë, ndër ta edhe të termit “muzikalitet”, duke u nisur nga fakti që shumëkush i vishte kësaj fjale llojlloj interpretimesh, jo rrallë diletanteske, të pathemelta, pra edhe të papërgjegjshme. “Po përpigem - u thoshte me modesti të pranishmëve, kolegë, studentë, apo edhe thjesht amatorë të muzikës, - të shfaq ndonjë mendim se si e shoh unë muzikalitetin”. Më tej vinte në dukje se edhe në ndonjë fjalor të vogël enciklopedik, termi i mësipërm përkufizohet me njëra prej, ose, të paktën, pamjaftueshëm: me lokucionet “karakter muzikor”, “veçoria

cilët e ngatërrojnë muzikalitetin me cilësinë e të qenit ritmik”.

Rëndësi të dorës së parë, Tonin Harapi i kushtonte edhe interpretuesit të muzikës që kompozonte: instrumentistët dhe këngëtarët. Lidhur me këtë të fundit, çmonte së tepërmi ata interpretues vokale, të cilët, duke shfrytëzuar cilësitë e lindura, por edhe punën që bënin kryesisht me vokaliza, arrinin ta zgjeronin diapazonin timbrik, nga tenor në bariton apo bas, ose, të paktën të përfitonin “ngjyra specifike”. Lidhur me këtë “dualitet”, mjeshtri Tonin Harapi tërhiqte vëmendjen se duhej treguar kujdes që të mos sforciohej zëri, përmes dozimit dhe intensitetit të tingujve.

Gjatë shkëmbimit të mendimeve me këngëtarë e sidomos me solistë, Tonin Harapi i këshillonte që edhe në shtëpi e kudo, të mos e shkëputnin vëmendjen nga pjesët e repertorit të tyre; të ushtroheshin e të përsërisnin pa pushim fragmente e pasazhe, jo vetëm nga pjesët që u kërkoheshin për koncerte të ndryshme, por sidomos nga vepra muzikore të famshme. Më tej, u thoshte se nuk duhej që medoemos ta quanin veten “bel-cantist” në kuptimin që ky nocion kishte në shekullin XIX e deri në vitet ‘25 të shekullit të kaluar.

Pa lënë pas dore teknikën muzikore, domethënë nevojën e përmirësimit të cilësisë së disa tingujve, që mund t’i ndjenin si “deficitare”, pa shpërfillur as përkryerjen e ndonjë fraze deri në një elegancë të caktuar artistike, ata, sipas Tonin Harapit duhej të fitonin edhe tiparet e aftësitë e një aktori lirik, për të cilin mishërimi i personazhit gjithmonë i paraprindë bukurisë së këngës apo të aries. Lidhur me këtë të fundit, Tonin Harapi mendonte se i vetmi dallim midis aktorit dramatik dhe atij lirik është se i pari shprehet duke folur, ndërsa i dyti duke kënduar, por të dy e kanë për detyrë të luajnë në skenë.

Që muzika e interpretuar në skenë, të kurorëzohej me sukses, çka ishte në nderin, jo vetëm të kompozitorëve përkatës, por edhe të interpretuesve, - këngëtarë e instrumentistë, - por edhe të dirigjentit të orkestrës, Tonin Harapi kishte bindjen se

ishite e domosdoshme që artistët të formojnë njëne nevoja që ndonjëri të bëjë çmos t’ia kalojë tjetrit (sidomos me mënyra e mjete të padrejta). E vetmja gjë e lejuar në garë, mendonte Tonin Harapi, është ambicia për ta kapërcyer vetveten, duke qenë i vetëdijshëm se vendi yt është dhe mbetet vendi yt. Atë nuk ta zë dot askush. Këtë të vërtetë e ka shprehur fort bukur edhe Zhan Kokto (Jean Cocteau): “Të gjithë besojnë se mund ta bëjnë shumë më mirë se ti. Jo më mirë. Por diçka tjetër”.

Tonin Harapi tregonte të njëjtin seriozitet, si në kompozimin e temave lirike, ashtu edhe të atyre epike; si në “skalitjen”

artistik të pashkëputshëm. Tonin Harapi duhet konsideruar si një model për brezat e rinj të kompozitorëve, të cilët duhet ta kuptojnë që spektaklet bashkëkohore nuk mund të mbahen më këmbë dhe nuk mund të prosperojnë përveçse përmes një zhvillimi harmonik të shumanshëm të të gjithë përbërësve.

Tonin Harapi ka pasur dhuntinë e jashtëzakonshme të ngulitjes në kujtesën e dëgjuesit e të shikuesit të mesazhit artistik të realizuar nëpërmjet tingujve të filtruar në sitën e imtë gjatë procesit krijues. Mesazhi i sapo përmendur nuk mund të harrohet lehtë, ngaqë ia del mbanë t’i mbivendoset vetëdijes sonë, me



Tonin Harapi

e karaktereve për rolet “e lehta” (në një këngë me vijë melodike të thjeshtë, apo në një komedi muzikore), ashtu edhe për rolet “e vështira”, me nuanca tragjike apo satirike (në oratoriot, kantatat, operat, operetat etj).

Tonin Harapi ka qenë artist kompleks, në kuptimin gjithëpërfshirës të fjalës, për të cilin tingulli muzikor dhe veprimi skenik shkrihen në një unitet

esencë e personazhit përkatës.

Mbresa që na le muzika e Tonin Harapit nuk ka të bëjë vetëm me përmasat e gjinisë në të cilën kompozon, por ajo mund të përftojë, qoftë edhe brenda disa çasteve, një imazh aq të veçantë, “të vizatuar” me aq elegancë, - ku pleksen mendimi i thellë dhe emociioni i fuqishëm, - sa që të mos na ndahet për vite me radhë pas kësaj.



“ Versionet që na ofron Tonin Harapi, kanë një originalitet, i cili na e pasuron, përmes rrugës së artit, përvojën tonë jetësore. Ato janë të ngjizura me atë që mund ta quajmë “tharm” vetjak i kompozitorit, i cili kumton disa rrjedha ndjesore me një efikasitet që mund të dëshmohej e të përjetohet nga çdo dëgjues apo spektator në koncertet me vepra të Tonin Harapit. ”

Natyrisht, nuk jemi në gjendje dhe as i kemi vënë për detyrë vetes të përcaktojmë me saktësi e në mënyrë të plotë “burimin” e talentit madhor të Tonin Harapit. Gjithsesi, mund të pohojmë se sukseset e tij i detyrohen një dhuntie krejt të veçantë, njësimi pothuajse total të tij me veprën që krijon. Asaj ai i fal pa kursim copëza nga jeta dhe nga shpirti i vet, duke hyrë në rezonancë me bërthamën e çdo gjendjeje shpirtërore që u vesh personazheve, duke përjetuar rrjedhohat e natyrshme në rrafshin e shprehshmërisë muzikore, falë një intuete dhe nuhatjeje të posaçme e të pangatërrueshme.

Versionet që na ofron Tonin Harapi, kanë një originalitet, i cili na e pasuron, përmes rrugës së artit, përvojën tonë jetësore. Ato janë të ngjizura me atë që mund ta quajmë “tharm” vetjak i kompozitorit, i cili kumton disa rrjedha ndjesore me një efikasitet që mund të dëshmohej e të përjetohet nga çdo dëgjues apo spektator në koncertet me vepra të Tonin Harapit.

Të bind fakti që kompozitori Harapi bëhet njësh me shpirtin e poezisë që do ta veshë me rrobet e notave, që do ta muzikojë, pra. Binjakëzimi që realizon midis vargut e notës, ndërmjet fjalës dhe melodisë, ka një inkandeshencë të atillë emotive, me theksa vetjakë, që mbartin vullën e frymëzimit subjektiv, sa që arrin të bëhet klasik, pa u ndarë kurrsesi nga faqja përkatëse e kompozuar.

Por, të gjitha këtotribute nuk lidhen vetëm me mrekullinë, pra me talentin e lindur. Ato janë rrjedhojë e një pune artistike të mundimshme, e një shqetësimi të paprerë për zgjerimin e horizontit kulturor, për përsosjen e mjeteve profesionale. Edhe pse Tonin Harapi ishte prej kohësh një erudit i mirëfilltë, jemi të bindur se ai, para se t'i përvishej punës për të shkruar një partiturë, mbledhte të dhëna gjithfarësh rreth ngjarjes apo protagonistit, kur, për shembull, ishte fjala për një eveniment apo personazh historik apo fryt i legjendave dhe i rrëfimeve popullore. E shfaqim këtë hamendje nga që Tonin Harapi përsiaste dhe eksperimentonte në variante të ndryshme

cilin do intonacion, analizonte domethënien e “linjave të forcës” të çdo fjale e note, “ngjyrën” e çdo rrokjeje, çka e çonte drejt shpërndarjes së intensitetit të theksave ekspresivë pas një dozimi të hollësishtëm, të përfutur njëherazi

nga logjika dhe nga mendimi. Emocioni i freskët dhe vibracioni i mishërimit të secilës situatë apo personazhi, i përkasin një artisti që, sa herë krijon, secilin çast e përjeton ndryshe nga tjetri, pa u prekur nga sëmundja e rutinës

dhe e mërzisë, njëlloj si në ditën e parë të daljes e të prezantimit me publikun artdashës e muzikofil Por, që të kuptojmë sa më mirë ku buron arti i Tonin Harapit, na vjen në ndihmë portretizimi i tij si njeri, ashtu siç kemi

pasur rastin fatlum ta njohim, sepse talenti nuk mund të ndahet nga shpirti i një artisti të vërtetë. Vepra e tij ngjason me një rrjedhë të vrullshme, të përkushtuar artit e atdheut. Rreshtimi mjeshër i tingujve në “foleza” të qëndrueshme dallëndyshesh të zellshme e të talentuara, në sytë e mosnjohësve paraqet hieroglifë të pakuptueshme, të shumëllojshme e të larmishme, që, në të vërtetë përfaqësojnë shpjellimin e lëndës në shtrirje e në lartësi, për të përfutur melodi e harmoni - jehona kumbuese të shpirtit krijues në një hapësirë të gjerë, të papushtueshme, të perceptueshme vetëm nga njerëz me ndjenja e me zemër. Ky mund të jetë thjesht një hamendësim i imi, por që padyshim mbart diçka të besueshme dhe bindëse.

Vetvetiu shtrohet pyetja: Ku gjenden ato emocione, ai ngacimim a shtysë shpirtërore, ajo dukuri artistike, që kërkon dhe e ndjen të domosdoshme të nxjerrë në dritë gjithë atë potencial të asaj linje poetike, të asaj rrjedhshmërie mendore dhe pse jo edhe të atyre qasjeve filozofike përmes të të menduarit dhe të krijuarit të një muzike vetanake?

Një nga përgjigjet e mbarëpëranueshme mund të ishte: Këto gjenden në shpirtin e në mendjen e kompozitorëve me devotshmëri të pasqur, në mesin e të cilëve bën pjesë Tonin Harapi, i cili ka krijuar vepra me vlera të larta artistike dhe humane në rrethana kohore dhe historike të vështira. Ai është një krijues që mbart binomin e kompozitorit dhe të kritikut, njeriut gjithnjë të gëzuar e të hareshëm, çka përputhet plotësisht me karakterin e tij të pastër, me shpirtin e zemrën e gjerë, të artistit të pajisur me virtytet më të larta njerëzore. Pra, mjaft t'i hidhje një vështrim të shpejtë fytyrës së tij simpatike dhe të dëgjoje vetëm dy a tri fjalë me atë zë si cicërimë zogju, dhe do të bindeshe se kishe lexuar botën e brendshme e të thellë të tij.

Këtë të vërtetë e pohon edhe muzikologu i mirënjohur Spiro Ll. Kalemli në librin e tij “Tonin Harapi”: “Për Tonin Harapin përmasa njerëzore e artistit është po aq e rëndësishme sa ajo njerëzore”.





Gjithë juve miq dhe bamirës të dashur, ju mundësojmë ta jepni kontributin përmes xh-rolloqarive bankare.

**Adm. Ap. e Prizrenit**  
**Numri i llogarisë:**  
 EUR: 1501 090000 1990 20  
 USD: 1501 090000 3765 30  
 CHF: 1501 090000 3764 33

| Valuta | Banka                                 | Shteti          | SWIFT/BIC   |
|--------|---------------------------------------|-----------------|-------------|
| EUR    | Raiffeisen Zentralbank Oesterreich AG | Vienna, Austria | RZBAATWW    |
| USD    | American Express Bank, LTD            | New York, US    | AEIBUS33    |
| CHF    | UBS AG                                | Zurich, CH      | UBSWCHZH80A |

Plotësoni formularin e mëposhtëm, dhe na e dërgoni bashkë me vërtetimin e pagesës në adresën tonë: **Rr. Gjon Pali II 1, 20000 Prizren.**

Emri: \_\_\_\_\_

Mbiemri: \_\_\_\_\_

Adresa: \_\_\_\_\_

Qyteti: \_\_\_\_\_

Kodi postar: \_\_\_\_\_

Numri i telefonit: \_\_\_\_\_

E-mail: \_\_\_\_\_

Për informata më të hollësishme, ju lutemi të na kontaktoni në numrin e telefonit: 029 241 933/14, me faks: 029 241 232 ose me email: [revistadrita@hotmail.com](mailto:revistadrita@hotmail.com) ose [revistadrita@yahoo.com](mailto:revistadrita@yahoo.com).



E PËRMUAJSHME FETARE - KULTURORE E KISHËS KATOLIKE



■ **SHIRUAN:**  
Dr. Don Lush GIERGIG

[illegible]

**Në shërbim dhe  
veprim nën "hijen"  
e Gjergj Kastriotit  
në Detroit**

11